REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

# RAPORT MONITORIMI
# JANAR – SHTATOR 2020

# STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË

www.drejtesia.gov.al

## Tabela e Përmbajtjes


I. Informacion përmbledhës mbi monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe planit të veprimit 2019 – 2021, për periudhën janar – shtator 2020. . .................................................... 4

II. Progresi i Strategjisë……………………………………………………………….................7

2.1 Reforma të implementuara me sukses nga institucionet e pavarura për periudhën janar – shtator 2020, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë.......................................................... 10

2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me axhendën e integrimit europian ........... 30

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit............ 31

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit........................................................................... 31

III. Progresi i zbatimit sipas objektivave specifike & masave........................................................ 32

3.1 Vlerësimi sipas secilit objektiv duke përdorur treguesit.......................................................... 38

3.2 Konkluzione dhe rekomandime ........................................................................................ 47


DRAFT

## LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---|---|
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| ASHSGJ | Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor |
| DNJF | Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas |
| DPB | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| DPP | Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit |
| DHKA | Dhoma Kombëtare e Avokatisë |
| DHKNd | Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve |
| DHKN | Dhoma Kombëtare e Noterëve |
| DHKPGJP | Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat |
| GJK | Gjykata Kushtetuese |
| GJL | Gjykata e Lartë |
| ILD | Inspektori i Lartë i Drejtësisë |
| IML | Instituti i Mjekësisë Ligjore |
| KED | Këshilli i Emërimeve në Drejtësi |
| KLGJ | Këshilli i Lartë Gjyqësor |
| KLP | Këshilli i Lartë i Prokurorisë |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KSHB | Komiteti Shqiptar i Birësimeve |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomise |
| ONM | Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| PV | Plani i Veprimit |
| QBZ | Qendra e Botimeve Zyrtare |
| SND | Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë |
| SPAK | Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar |
| SHM | Shkolla e Magjistraturës |
| SHKBB | Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve |
| SHP | Shërbimi i Provës |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

DRAFT

## I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2019 – 2021, PËR PERIUDHËN JANAR – SHTATOR 2020.

Reforma në Drejtësi ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme të zbatimit të saj. Institucionet të cilat operojnë në sistemin e drejtësisë janë angazhuar plotësisht, për të pasur një sistem në përputhje me standardet që një vend në pritje të hapjes së negociatave duhet të ketë dhe duhet të realizojë.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 773, datë 2.11.2016, ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit. **Misioni** i kësaj strategjie është zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane.

Ky dokument përmban *tetë objektiva strategjikë të nivelit të lartë*, të cilat janë:

1. Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
2. Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.
3. Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
4. Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
5. Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
6. Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.
7. Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë.
8. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Përsa më sipër, në kuadër të thellimit të angazhimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe reflektimin e saj në zbatimin e Planit të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën 2019 - 2021. Për këtë qëllim, u hartua Pasaporta e Indikatorëve, në funksion të objektivave të strategjisë. Në muajin qershor, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 409, datë 19.06.2019 ka miratuar Planin e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Metodologjia e ndjekur në rishikimin e Planit të Veprimit ishte përfshirja e të gjithë institucioneve përgjegjëse, të identifikuara në Planin e Veprimit të mëparshëm, marrja e kontributeve dhe parashikimeve të tyre direkte në hartim dhe zbatim të masave. Masat e parashikuara janë ideuar mbi bazë rezultati konkret, të matshëm dhe janë të kostuara. Gjatë parashikimit të masave u aplikua ndërlidhja ***objektiv-indikator-masë***. Objektivat e Strategjisë janë organizuar dhe ndarë në nën-objektiva për të bërë të mundur një organizim më të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë të masave të parashikuara dhe të lidhura me to. Është aplikuar formati i parashikimit të masave me target/*milestones.*

Masat e reja të Planit të Veprimit 2019 - 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë synojnë të intensifikojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të reja në drejtësi, si KLGJ, KLP, ILD, KED, të SPAK e Gjykatës së Posaçme (GJPKKO), të thellojnë formimin tekniko-profesional të sistemit të drejtësisë nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve, prokurorëve e administratës gjyqësore apo dhe rritjen e aksesit në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Plani i Veprimit 2019-2021, i jep një hov zhvillimi përmirësimit të gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe të tjera përmirësime në infrastrukturë. Organet e reja në drejtësi parashikohen të jenë të pajisura me kushte dhe mjete pune funksionale.

Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë, pjesë e Planit të Veprimit 2019-2021, vijnë me masa konkrete në drejtim të zhvillimit strukturor, organizativ dhe thellim kapacitetesh njerëzore e profesionale për të bërë të mundur detyrimet që vijnë nga Strategjia.

Profesionet e lira ligjore janë bërë pjesë e Planit të Veprimit 2019-2021, me masa të parashikuara për t`u përmbushur dhe që vijnë si produkt i ndryshimeve ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 166, dt. 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, në Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive.

Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën nga *1 janar 2020 deri në 30 shtator 2020* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit të SND-së**.** Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Çdo institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivi dhe aktiviteti, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të masave, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektivi. Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht online, për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, për të siguruar saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura.

*Pas hartimit të draft raportit*, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikon draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft-raportin e monitorimit para se të miratohet nga Mekanizmi Institucional i Monitorimit/Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi.

Në zbatim të VKM nr. 773, datë 2.11.2016, mbi miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka menaxhuar mekanizmin institucional për monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Mekanizmi institucional për monitorimin e kësaj strategjie realizohet nëpërmjet një strukture të veçantë, në përbërjen e të cilit janë:

• Zëvendësministri i Drejtësisë;
• 5 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
• 1 përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
• 1 përfaqësues nga Këshilli i Ministrave që mbulon çështjet e koordinimit të dokumenteve strategjike;
• 1 përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
• 1 përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
• 1 përfaqësues nga Inspektorati i Lartë;
• 1 përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese;
• 1 përfaqësues nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm;
• 1 përfaqësues nga Shkolla e Magjistraturës;
• 1 përfaqësues nga Avokati i Popullit;
• 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
• 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterëve;
• 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat;
• 1 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.

Përsa më sipër të gjitha institucionet kanë përcaktuar përfaqësuesit e tyre në mekanizimin e monitorimit. Ky mekanizëm vlerëson dhe miraton Raportet periodike të Monitorimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Për më tepër, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 *"Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar",* janë krijuar 5 Komitete Drejtuese Sektoriale (KDS). Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është parashikuar ngritja e Komitetit Drejtues Sektorial (KDS) për Reformën në Drejtësi.

Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi, drejtohet nga Ministri i Drejtësisë dhe ka anëtarë:

- Ministrin e Drejtësisë;
- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave;
- Kabinetin e Kryeministrit (ZOS, Këshilltarë);
- Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri;
- Departamentin e Burimeve, Transparencës dhe Miradministrimit, në Kryeministri.

*Të ftuar:* Përfaqësues nga Kuvendi, KLP, KLGJ, KED, PP, SHM, ILDKPKI, Avokati Popullit, Dhomat Kombëtare (të Avokatisë, Noterëve, Ndërmjetësve, Përmbaruesve), Donatori/Pika fokale për fushën etj., si dhe të tjerë, sipas vendimmarrjes nga drejtuesi i KDS-së.

KDS do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

Në kontekstin e integrimit evropian, këto struktura do të luajnë rolin e Komitetit Sektorial Monitorues për projektet IPA, duke siguruar raportimin e monitorimit të fondeve IPA, sipas sektorëve.

## II. PROGRESI I STRATEGJISË

Plani i Veprimit 2019- 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, konsiston në:

- ✓ 8 objektiva strategjikë;
- ✓ 11 indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve;
- ✓ 7 indikatorë transhi të Bashkimit Evropian;
- ✓ 65 masa.

Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin apo/dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë, nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacioni nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e SND-së. Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 dhe mbulon progresin gjatë periudhës 1 janar – 30 shtator 2020.

*Plani i Veprimit përbëhet nga 8 objektivat e mësipërme dhe përmban në total 65 masa.* Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të masave të SND bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse. Ministria e Drejtësisë ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë muajit korrik 2020. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për periudhën janar – shtator 2020, rezulton se niveli i zbatimit të masave të Planit të Veprimit është si më poshtë:

DRAFT

## Statusi aktual i zbatimit të masave sipas Objektivave
## Janar Shtator 2020




***Për periudhën janar – shtator 2020 nga 65 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2019 – 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë realizuar 19 prej tyre, 40 prej tyre janë ende në proces zbatimi, dhe 6 masa janë të parealizuara.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 është në nivelin 29% për masat të cilat janë të realizuara, 62% për masat në proces, si dhe 9% për masat të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Krahasuar me periudhën janar - qershor 2020 të monitorimit, gjatë të së cilës ka rezultuar se nga 65 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2019 – 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë raportuar: të realizuara 18 prej tyre, 41 prej tyre janë në proces zbatimi, dhe 6 masa janë raportuar të parealizuara, **vihet re se kemi një rritje të numrit të masave të realizuara me 1 masë, kemi një ulje në numrin e masave në proces me 1 masë dhe një qëndrueshmëri në numrin e masave të parealizuara.**

DRAFT

## Statusi i zbatimit të masave Janar – Shtator 2020




**<u>Statusi i zbatimit të masave Janar - Qershor 2020</u>**



## 2.1 REFORMA TË IMPLEMENTUARA ME SUKSES NGA INSTITUCIONET E PAVARURA PËR PERIUDHËN JANAR – SHTATOR 2020, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË.

- *<u>Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë</u>*

  - *Këshilli i Lartë Gjyqësor*

KLGJ, raporton se gjatë vitit 2020 ka vijuar intensivisht punën në drejtim të zbatimit të reformës në drejtësi, miradministrimit të gjykatave, zhvillimit të karrierës së magjistratëve, rritjes së efiçencës së sistemit të drejtësisë, përmirësimit të llogaridhënies dhe transparencës në vendimmarrje.

Gjatë periudhës 1 Janar – 30 Shtator 2020, prej saj janë zhvilluar 58 mbledhje plenare dhe janë marrë 375 vendime të karakterit normativ dhe rregullator.

Për sa i përket **strukturës organizative**, KLGJ, bazuar në Vendimin nr. 12 datë 18.01.2019, i ndryshuar ka një administratë me të gjithë njësitë e duhura mbështetëse. Në total, nga momenti i miratimit të strukturës deri në 30 shtator 2020, struktura është plotësuar në masën 82.4% (103 punonjës nga 125 të miratuar). Kjo ka mundësuar rritjen e efikasitetit në çdo njësi, si dhe ka rritur cilësinë e përpunimit të akteve, shkresave, si dhe përmirësim të ndjeshëm të afateve kohore të realizimit të këtyre detyrave.

Procesi i rekrutimeve për të përmbushur strukturën e miratuar të KLGJ-së me 125 punonjës dhe për pasojë funksionimin e saj me kapacitet të plotë, raportohet se po vijon më intensivisht që nga momenti i transferimit tek mjediset e Polit të Drejtësisë (gusht 2020), ku janë siguruar hapësirat e nevojshme të punës.

Për sa i përket **procesit të rivlerësimit kalimtar**, KLGJ, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për periudhën Janar – Shtator 2020 kanë organizuar 111 shorte për përzgjedhjen e dosjeve për 111 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Janë depozituar pranë KPK-së dhe ONM-së 40 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me 200 dosje gjyqësore për 40 subjekte rivlerësimi si dhe janë në proces dorëzimi (të përfunduar) 12 raporte të tjera.

Gjithsej, duke marrë parasysh edhe punën e realizuar që nga momenti i krijimit të organeve të pavarura të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, deri më 30 shtator 2020 janë dorëzuar pranë KPK dhe ONM 250 raporte vlerësimi.

**Procesi i vënies në funksionim të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, i konsideruar si një ndër prioritetet kryesore të KLGJ-së, ka përfunduar dhe funksionimi i tyre është shpallur me vendimin Nr.286 datë 18.12.2019.

KLGJ, me Vendimin nr.70, datë 7 shkurt 2020, miratoi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Ky vendim përcakton rregulla të detajuara që zbatohen për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë, përfshirë Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Situata aktuale për sa i përket trupës gjyqësorë të këtyre gjykatave, si rrjedhojë e procesit të Vettingut, është si më poshtë:

DRAFT

Në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë vetëm 5 gjyqtarë të emëruar në mënyrë të përhershme nga 11 të parashikuara me ligj, ndërsa Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, funksionon me 10 gjyqtarë nga 16 të parashikuar me ligj. Nga këta, 6 gjyqtarë janë të emëruar përkohësisht dhe 4 gjyqtarë janë caktuar në mënyrë të përhershme.

Për të plotësuar pozicionet e lira në këto gjykata të posaçme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka publikuar thirrjet për 5 vende të lira për secilën nga gjykatat. Për shkak të numrit të kufizuar të aplikimeve, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 10.09.2020, vendosi rihapjen (për herë të tretë) e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjithsej për katër pozicione të lira si dhe rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjithsej për dy pozicione të lira.

Me ligjin nr. 15/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, u rregulluan kryesisht çështje që kanë të bëjnë me shtesën në pagë për vjetërsi pune për magjistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në reflektim të këtyre amendimeve ligjore, pritet të rritet numri i aplikimeve për gjyqtarë në gjykatat e posaçme.

Në lidhje me **zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve**, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 70, datë 07.02.2020 "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve" përcaktoi rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Rregullat e këtij vendimi janë të zbatueshme për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë dhe që përmbushin kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në:

a) Gjykatën e Lartë;

b) Gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar;

c) Gjykatën Administrative të Apelit;

ç) Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Një tjetër element i rëndësishëm për karrierën e gjyqtarëve është edhe plotësimi i kuadrit nënligjor për krijimin e **skemës së vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve**. Në këtë kuadër janë hartuar edhe aktet nënligjore për realizimin e këtij procesi me synim (i) përmirësimin e vazhdueshëm të aspektit etik dhe profesional të gjyqtarëve; (ii) vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve; (iii) zhvillimin e karrierës së gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale, si dhe (iv) identifikimin e nevojave për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues.

Në funksion të zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve duhet theksuar edhe **miratimi i programit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve** për vitin 2020 që parashikon vlerësimin e 121 gjyqtarëve përgjatë vitit 2020.

DRAFT

Këshilli, me vendimin nr. 198, datë 11.06.2020 (18 gjyqtarë) dhe me vendimin nr. 233, datë 02.07.2020 (3 gjyqtarë), filloi procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe caktoi relatorin dhe nëpunësin përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar. Aktualisht ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për gradimin e 21 (gjyqtarëve;

Duke marrë në konsideratë që një nga qëllimet më të rëndësishme për të cilat ndërmerret vlerësimi i gjyqtarëve është ngritja në detyrë e tyre, KLGJ, me vendimet nr. 247 datë 09.07.2020 dhe nr. 314, datë 14.09.2020, "Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019", ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 24 (njëzetekatër) gjyqtarë, vlerësim i cili do të bazohet në veprimtarinë gjyqësore të vitit të fundit.

KLGJ, në përputhje me objektivin nr. 3 të Planit Strategjik të KLGJ "**Sigurimi i mirëfunksionimit të gjykatave**, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave", miratoi me vendimin Nr. 316, datë 14.09.2020 rregulloren për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ky akt normativ përcakton elementet kryesore procedurale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me procedura disiplinore të zhvilluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj gjyqtarëve të të gjithë niveleve.

Këshilli, në kuadrin e përmirësimit të **menaxhimit elektronik të çështjeve**, ka ndërmarrë masat e nevojshme për të mundësuar transferimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve dhe kontratat përkatëse nga MD. Ky sistem është marrë në administrim nga KLGJ në muajin shtator të vitit 2019.

Gjithashtu, është bashkëpunuar me MD duke dhënë opinion lidhur me projektvendimin për ngritjen e **Qendrës së Teknologjisë së Informacionit**. Aktualisht, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë, nuk është ngritur ende dhe kjo për rrjedhojë ka penguar përmbushjen e masave lidhur me zhvillimin e një programi pilot për gjykatat.

KLGJ ka realizuar një **studim mbi problematikat e sistemit të menaxhimit të çështjeve** në gjykata, sipas kategorive të prioriteteve, për t'u mbajtur parasysh për përmirësimin e sistemit.

KLGJ, gjithashtu, është duke kryer një **studim për zhvillimin e projektit të sistemit të ri menaxhimit të çështjeve**. Është parashikuar nevoja për resurse financiare, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë (Misioni EURALIUS V) por kostoja përfundimtare do të përllogaritet në përfundim të miratimit të projektit dhe opsioneve të përzgjedhura.

Sistemi i ri pritet të jetë një sistem i unifikuar me mundësinë e bashkëveprimit me sistemet aktuale në përdorim nga institucionet e tjera (Prokuroria, QKB, etj.), në përputhje me praktikat dhe me standardet me të mira ndërkombëtare.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ përgjegjës për miratimin e **rregullave dhe kodit të etikës** dhe për monitorimin e tyre, dhe specifikisht Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, po konsideron me prioritet përgatitjen e draftit të parë të standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, sipas Ligjit nr. 115/2016.

Me vendimin nr. 208, datë 11.10.2019, KLGJ caktoi një gjyqtar si këshilltar për etikën.

Në kuadrin e **rritjes së transparencës së vendimmarrjes** në procesin e emërimeve / promovimeve të gjyqtarëve, kriteret dhe metodologjia e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve është publikuar në

DRAFT

faqen zyrtare të KLGJ: konkretisht kategoria e vendimeve me karakter normativ: http://klgj.al/akte-normative-nënligjore/.

Gjithashtu, janë publikuar në vijimësi thirrjet për kandidim, listat e kandidatëve, rezultatet e verifikimit dhe rezultatet përfundimtare të vlerësimit.

Për sa i përket **bashkëpunimit mes KLGJ dhe SHM**, vlen të theksohet që KLGJ ka dhënë opinion në mbledhjen plenare të datës 2 korrik 2019 për draft programin tematik 2019-2020 të ShM si dhe kurrikulat e trajnimit 8 javor për kancelarët e gjykatave. Gjithashtu, një pjesë e anëtarëve të KLGJ kontribuojnë edhe në rolin e lektorëve të ftuar në trajnimin fillestar në ShM, si edhe të ekspertëve në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve.

Këshilli, në lidhje me komandimin e gjyqtarëve si pedagogë të brendshëm, ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës dhe ka treguar kujdesin maksimal për të siguruar transparencë të plotë në vendimmarrje dhe rritje të kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës.

KLGJ ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, sipas parashikimeve ligjore, për ta bërë **Gjykatën e Lartë** plotësisht funksionale, megjithëse procesi në vetvete ndërlidhet me dinamikën e procesit të vettingut dhe numrin e aplikimeve të paraqitura.

Konkretisht, KLGJ ka punuar me shumë kujdes për të hartuar një paketë të plotë aktesh nënligjorë dhe rregullatorë që përcaktojnë rregullat dhe kritere të qarta për përzgjedhjen e kandidatëve, duke garantuar që procesi i përzgjedhjes të kryhet në një mënyrë të hapur dhe transparente, dhe rezultati i tij të mos komprometohet ose paragjykohet.

Paketa nën-ligjore e hartuar dhe miratuar nga KLG i hapi rrugën fillimit të dy proceseve paralele që lidhen me rekrutimin e juristëve të shquar dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve brenda sistemit. Kjo paketë ligjore, përcakton rregullat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, duke garantuar që procesi i përzgjedhjes të kryhet në një mënyrë të hapur dhe transparente, dhe që rezultati i procesit të përzgjedhjes të mos komprometohet ose të paragjykohet.

Me miratimin e këtyre vendimeve KLGJ hapi thirrjen **për aplikime nga juristë të shquar** si dhe nga vetë sistemi gjyqësor:

Në korrik dhe shtator 2019, KLGJ hapi thirrjen për 4 vende të lira për Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të shquar. Këshilli zhvilloi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për kandidatët e paraqitur dhe në përfundim me datë 5.03.2020 KLGJ i dorëzoi Presidentit të Republikës listën e kandidatëve të propozuar për emërim në GJL. Presidenti i Republikës bëri dekretimin e tyre, ndërsa për kandidatin e katërt nga radhët e juristëve të shquar është në përfundim procesi i vlerësimit.

Paralelisht me procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të shquar, KLGJ ka **shpallur 11 vende të lira nga brenda sistemit gjyqësor** (3 në fushën e të drejtës civile, 4 në atë administrative dhe 4 në atë penale) aplikimi për të cilat ka përfunduar në muajin gusht 2020. Aktualisht, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës po verifikon përmbushjen e kritereve ligjore për kandidaturat e paraqitura. Për ata kandidatë që nuk i janë nënshtruar ende procesit të verifikimit, sipas kërkesës ligjore, KLGJ ka kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit që të kryejë me përparësi vlerësimin e pasurisë.

Vlen të përmendet se procesi i verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për në Gjykatën e Lartë është i gjatë për shkak të komunikimeve ndërinstitucionale dhe informacionit shumë të detajuar që kërkohet.

DRAFT

Duhet theksuar gjithashtu se ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë lidhet ngushtë edhe me ritmin e procesit të Vettingut. Aktualisht, numri i gjyqtarëve që përmbushin kriteret ligjore të emërimit në Gjykatën e Lartë dhe që kanë kaluar procesin e Vettingut është i kufizuar dhe kjo ka sjellë edhe një numër të ulët aplikimesh.

Një masë tjetër e marrë nga Këshilli për ri-funksionimin e Gjykatës së Lartë është miratimi i **Memorandumit të Mirëkuptimit mes KLGJ dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)**.

Mbështetja e administratës së Gjykatës së Lartë me burime njerëzore në mënyrë që të zvogëlohet stoku i çështjeve të prapambetura është ndër kontributet më të rëndësishme që ofron ky Memorandum. Gjithashtu, Memorandumi i mirëkuptimit parashikon përmirësimin dhe modernizimin e proceseve të punës në këtë gjykatë, si dhe zbatimin e TIK-ut në funksion të transparencës dhe marrëdhënieve me publikun.

Aktualisht, 12 operatorë janë angazhuar në uljen e numrit të çështjeve të pazgjidhura dhe po punojnë për të krijuar një inventar të detajuar të pothuajse 35,000 çështjeve të mbetura në këtë gjykatë. Ky inventar do të shërbejë si bazë për kategorizimin e çështjeve në grupe, të cilat më pas do të adresohen nga këshilltarët ligjorë dhe gjyqtarët. Vlen të përmendet gjithashtu se kohët e fundit, Këshilli, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, ka zhvilluar një Udhëzues për Efikasitetin e Gjykatës së Lartë dhe Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura. Ky dokument, i cili parashikon një sërë masash konkrete, të përqendruara kryesisht në ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të kualifikuar dhe emërimin e më shumë këshilltarëve ligjorë, synon të adresojë situatën e krijuar në këtë gjykatë për shkak të numrit të lartë të çështjeve në pritje.

Në lidhje me **reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë**, Këshilli me vendimin Nr.317 datë 19.12.2019, ka miratuar ngritjen e një komisioni të përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë. Përballë numrit të jashtëzakonshëm dhe kohës së gjatë të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar dhe në respektim edhe të kritereve ligjore për gjykimin e tyre, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve vlerësoi se do të vijohet menjëherë me shqyrtimin e rekurseve të çështjeve të themelit, nisur nga kriteri i kohës së paraqitjes së tyre për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, krahas çështjeve të tjera që për nga natyra e tyre dhe sipas ligjit duhet të shqyrtohen në mënyrë të shpejtë, sikurse janë mosmarrëveshjet për juridiksionin, kompetencën, kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve.

KLGJ është në përfundim të procesit të **rishikimit të hartës gjyqësore**. Grupi ndërinstitucional i punës, (i përbërë nga përfaqësues nga gjykatat e vendit, KLGJ, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë si: Këshilli i Evropës, EURALIUS dhe Projekti "Drejtësi për të Gjithë" - USAID), bazuar në metodologji dhe standarde ndërkombëtare, pas një analize paraprake, ka përfunduar draftin e hartës së re gjyqësore. Ky draft i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë më datë 29 shtator 2020.

Në vijim, dhe pas konsultimeve me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe aktorë të tjerë, draft propozimi do t'i përcillet Këshillit të Ministrave në formën e një projektvendimi. Nisma është planifikuar në katër mujorin e tretë të vitit 2020.

**Blerja dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike** është realizuar nga të gjitha gjykatat sipas parashikimeve buxhetore. Gjithashtu KLGJ ka realizuar procedurat e prokurimit për 3 procese:

- "Abonim programi financiar në Cloud" për 38 gjykata

- “Mirëmbajtje e sistemit audio RDA nëpër sallat e gjyqit në Gjykata” për 38 gjykata
- “Mirëmbajtje e sistemit ICMIS dhe ARKIT" për 38 gjykata.

Realizimi i **investimeve infrastrukturore në gjykata** varet nga rezultati i hartës së re gjyqësore me qëllim për të rritur efiçencën e shpenzimeve buxhetore. Në vijim, realizimi i investimeve do të shqyrtohet rast pas rasti, për shkak të kufizimeve buxhetore me të cilat përballet edhe sistemi gjyqësor.

Analiza mbi **normën e likuidimit të çështjeve** është bërë në shkallë vendi në kuadrin e raportit vjetor të KLGJ-së. Për sa i përket veprimeve konkrete për rritjen e normës të likuidimit të çështjeve, KLGJ ka ndërmarrë një numër masash në lidhje me delegimet e gjyqtarëve dhe transferimin e përkohshëm. Po në këtë drejtim shërben edhe Vendimi Nr.78 datë 30.05.2019 “për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përfunduar procesin e **emërimit dhe caktimit në detyrë të magjistratëve** të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe 2019, duke emëruar në detyrë 25 magjistratë të diplomuar në vitin 2018 dhe 2019. KLGJ ka në proces emërimin dhe caktimin në detyrë të magjistratëve që kanë përfunduar studimet në vitin 2020, gjithsej 19 kandidatë për magjistratë, për të cilët relacionet e vlerësimit janë në përfundim e sipër dhe pritet që të diskutohen në mbledhjen plenare të Këshillit, brenda muajit tetor 2020.

KLGJ, me vendimin Nr. 31, datë 23.01.2020 ka përcaktuar **numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar** pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, që është 40, ndërsa, numri i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, është 25.

Kjo rritje e numrit të vendeve për kandidatë magjistratë, gjithnjë në respekt të ruajtjes së standardeve më të mira të pranimit, synon plotësimin sa më shpejt dhe me cilësi të pozicioneve të lira në sistemin gjyqësor, të krijuara edhe si rrjedhojë e procesit të Vettingut.

Këshilli ka trajtuar gjithsej 446 kërkesa për caktim gjyqtari, në përgjigje të të cilave janë marrë vendimet për 637 **caktime të gjyqtarëve**, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyre të përhershme.

**Monitorimi i aktivitetit të gjykatave** vijon rregullisht dhe bëhet në bazë të raportimeve periodike tremujore. Po kështu po punohet për përmirësimin e nivelit të regjistrimit audio të seancave gjyqësore dhe për publikimin në kohë të vendimeve gjyqësore.

KLGJ, me vendimin nr. 68 datë 24.04.2019, ka përcaktuar **anëtarin për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun**. Gjithashtu, KLGJ, me urdhrin nr. 19 datë 09.04.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm, ka miratuar “Programin e Transparencës për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Me vendimin Nr. 126, datë 19.07.2019, KLGJ miratoi **Planin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor**, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë për vitet 2019-2020, ku Objektivi nr. 5 i tij është përmirësimi i marrëdhënieve midis gjyqësorit, partnerëve dhe publikut, përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie të qartë komunikimi.

Aktualisht, KLGJ, në bashkëpunim me partnerët e Projektit “Drejtësi për të gjithë” (USAID), ka përfunduar hartimin e **Projekt-planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor** , nëpërmjet të cilit synohet përcaktimi i bazave për përmirësimin marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me

gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve.

Po ashtu, KLGJ ka përfunduar hartimin e **projekt-rregullores "Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median"**, nëpërmjet të cilës synohet përcaktimi i parimeve, rregullave dhe procedurave të veçanta për komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj.

KLGJ, me vendimin Nr.280 datë 10.12.2019, ka caktuar 8 **gjyqtarët për mediat**, në çdo juridiksion apeli.

Në datën 22 janar 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi së bashku me Projektin "Drejtësi për të gjithë" (USAID), një aktivitet me gjyqtarët për mediat, nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun, si edhe me disa gazetarë që mbulojnë çështjet e drejtësisë.

Me ndihmën e projektit "Drejtësi për të gjithë" (USAID) u mundësua edhe vënia në funksionim e faqes së re të internetit http://klgj.al/ ku pasqyrohet në mënyrë transparente e gjithë veprimtaria e KLGJ.

Nga ana e gjykatave kryhet publikimi i të gjitha vendimeve, por sistemi aktual i menaxhimit të çështjeve nuk mundëson procesin automatik të fshirjes së të dhënave personale në tekstin e vendimeve gjyqësore. Aktualisht anonimizimi i të dhënave kryhet manualisht, dhe për rrjedhojë konsumon shumë kohë fizike dhe kërkon burime njerëzore shtesë.

Faqja www.gjykata.gov.al është në fazën e prokurimit.

KLGJ, në bashkëpunim me Projektin ""Drejtësi për të gjithë" (USAID)", është duke punuar për **krijimin e një portali elektronik të unifikuar** të sistemit gjyqësor ku KLGJ dhe të gjitha gjykatat do të kenë faqen e tyre të dedikuar. Ky portal do të mundësojë një transparencë më të mirë të veprimtarisë gjyqësore të gjykatave.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar dhe vënë në funksionim një numër aktesh rregullatorë që synojnë **përmirësimin e efiçencës dhe të pavarësisë së gjykatave** si: skema e delegimit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera, zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave etj. Kjo edhe në përgjigje ndaj problemeve të evidentuara në lidhje me mungesën e gjyqtarëve, numrin e çështjeve të mbartura dhe procedimeve të zakonshme të gjykatave në nevojë.

Në përputhje me objektivin nr. 3 të Planit Strategjik të KLGJ "Sigurimi i mirëfunksionimit të gjykatave, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave", KLGJ, me vendimin Nr. 316, datë 14.09.2020 miratoi **rregulloren për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor**. Kjo rregullore, përcakton rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me procedura disiplinore të zhvilluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj gjyqtarëve të të gjithë niveleve, në funksion të vendosjes së standardeve që garantojnë një sistem gjyqësor sa më profesional dhe etik.

- *Këshilli i Lartë i Prokurorisë*

KLP është një nga institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili u krijua në kuadër të reformës në drejtësi, pas ndryshimeve në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe miratimit të ligjeve të posaçme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve që përbëjnë sistemin e drejtësisë.

Neni 149, i Kushtetutës parashikon se KLP është organ kolegjial i përbërë nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 anëtarë zgjidhen nga radhët e prokurorëve të të gjitha niveleve dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi midis radhëve të juristëve. Përkatësisht, më datë 11 dhjetor 2018, u mbajt Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e gjashtë anëtarëve prokurorë të KLP, ndërsa takimi i parë i KLP u mbajt më datë 19 dhjetor 2018, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit.

KLP garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

Për periudhën Janar- Shtator 2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë raporton veprimtarinë si më poshtë vijon:

## 1. Procedura e kandidatëve të tjerë për prokuror të SPAK

Sa i përket SPAK, me Vendimin nr. 10/1, datë 07.01.2019, "Për shpalljen e vendeve vakante për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, KLP vendosi të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 15 vendeve vakante për prokurorë në SPAK, përmes procedurës së ngritjes në detyrë.

Prokuroria e Posaçme përbëhet aktualisht nga 13 anëtarë. Tetë prej tyre janë emëruar gjatë vitit 2019 dhe pesë të tjerë janë emëruar gjatë periudhës Janar-Shtator 2020. Dy prokurorë janë pjesë e listës së 15 prokurorëve të kualifikuar nga ana e KLP, të cilët janë emëruar pas kalimit me sukses të Vetting-ut. Tre të tjerë janë përzgjedhur sipas procedurave të konkurrimit, si rezultat i tre vakancave të krijuara, për shkak të largimit të tri prokurorëve nga gara.

Dy kandidatë ndodhen në fazat si më poshtë vijon:

• Vazhdojnë procesin e rivlerësimit kalimtar dy prokurorë të cilët janë kualifikuar nga KLP, konkretisht Znj. Elisabeta Imeraj në shkallën e parë KPK (nuk ka ende një datë të caktuar për seancë gjyqësore), dhe Z. Anton Martini në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

• Për Z. Anton Martini, më datë 20.07.2020 në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit u hodh shorti për caktimin e trupit gjykues, kryesuesin e këtij trupi dhe relatorin e çështjes. Pritet caktimi i datës së seancës gjyqësore.

## 2. Aktet e miratuara nga KLP në periudhën Janar-Shtator 2020

Për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë marrë këto vendime:

- 87 Vendime komandimi dhe caktimi të përkohshëm prokurorësh;
- 1 Vendim për Komandimin e një magjistrati pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 10 Vendime emërimi prokurorësh;
- 1 Vendim ndërprerje komandimi;
- 2 Vendime dhe njoftim shpallje me qëllim plotësim vendesh për Komandim magjistrati pranë KLP dhe ILD;

- 1 vendim emërimi të 3 prokurorëve në SPAK;
- 2 Vendime për miratim opinioni për 2 prokurorë për komandim në EUROJUST.

Për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale janë marrë këto vendime:

- 12 Vendime për miratimin e Relacionit mbi verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës;
- 3 Vendime për miratimin e Raportit për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatëve për t'u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.
- 41 Vendime për miratimin e Raporteve për analizimin e aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit (prokuror);
- 1 Vendim për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës për magjistratët, kandidatë për t'u komanduar ndihmësmagjistrat pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 4 Vendime për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit;
- 3 Vendime për mbarimin e statusit së prokurorit;
- 1 Vendim për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë;
- 1 Vendim për miratimin e lejes së papaguar për një prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Nga Komisioni i Disiplinës, në lidhje me procedimin disiplinor ndaj magjistratit Znj. Elina Kombi, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës Parë, Tiranë, më datë 23.09.2020, ora 11.00, është zhvilluar seanca dëgjimore e KLP, me pjesëmarrjen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani dhe të Prokurores subjekt procedimi disiplinor, Znj. Elina Kombi, në lidhje me kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrje masë disiplinore "vërejtje publike". Gjatë kësaj seance dëgjimore janë dëgjuar pretendimet e të dy palëve, si dhe janë drejtuar pyetjet palëve në procedim. Me Vendimin e KLP, kjo seancë u mbajt me dyer të mbyllura.

Procedimi disiplinor është në proces nga Komisioni i Disiplinës, sipas dispozitave dhe afateve të parashikuara në Ligjin Nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve, janë përgatitur dhe miratuar 15 vendime për mbrojtjen e veçantë të prokurorëve.

Janë marrë gjithashtu dy vendime për mbarimin e mandatit të anëtarit të KLP, për Z. Besnik Cani (Vendim i KLP nr. 76, datë 04.03.2020, pas njohjes me Vendimin nr. 2, datë 27.02.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkarkimin e tij dhe relacionit të përgatitur nga Komisioni i Disiplinës) dhe për Z. Arben Dollapaj (Vendim i KLP nr. 90, datë 25.03.2020, pas njohjes me Vendimin nr. 4, datë 12.03.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkarkimin e tij dhe relacionit të përgatitur nga Komisioni i Disiplinës).

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me Vendimin nr. 1, datë 15.01.2020 ka vendosur që, numri i kandidatëve për prokurorë në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021 të jetë 35 (tridhjetë e pesë).

Gjatë muajit Prill, është miratuar Raporti "Mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën janar 2019-dhjetor 2019", i cili i dërgohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, detyrim që rrjedh nga ligji.

U miratua Vendimi nr. 96, datë 15.04.2020, "Për krijimin dhe administrimin pranë KLP të dosjes personale dhe regjistrit të prokurorëve", si bazë unike e të dhënave profesionale dhe personale të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, është miratuar kalendari dhe lista e prokurorëve që do të marrin pjesë në trajnimet e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës për periudhën Janar-Mars dhe Prill-Qershor 2020.

### 3. Akte nënligjore

Është miratuar:

- Rregullorja "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë".

- Rregullorja "Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit".

Janë në proces:

- Rregullorja "Për komandimin e magjistratit në një institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë".
- Rregullorja "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit të juridiksionit të përgjithshëm".
- Rregullorja "Mbi rregullat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve".
- Rregullorja "Për mënyrën e kompensimit për orët shtesë të punës të kryera nga nëpunësit civilë të prokurorisë".
- Rregullorja "Për përcaktimin e procedurave të zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj magjistratëve prokurorë".
- Rregullore për vlerësimin e performancës në punë të prokurorëve.

### 4. Aktivitete të tjera

- Betimi i dhjetë prokurorëve të rinj, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019.

Më datë 17.02.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi ceremoninë e betimit të prokurorëve të rinj, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2018-2019.

Ceremonia u mbajt në prani të anëtarëve të Këshillit, Ambasadorit të Delegacionit të Bashkimit Europian Z. Luigi Soreca, përfaqësuesve nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, EURALIUS, OPDAT, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Z. Arben Kraja, si dhe disa prej drejtuesve të prokurorive në rretheve.

- Procedurat për emërimin e kandidatëve për prokurorë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.

Më datë 30.09.2020, KLP miratoi 2 Vendime për miratimin e Relacionit për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit, si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatit për t'u emëruar prokuror, pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.

DRAFT

Njëkohësisht KLP bëri shpalljen e dy vendeve vakante për dy kandidatët prokurorë, të cilët pritet të emërohen së shpejti.

- Raportimi për veprimtarinë vjetore në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Më datë 10.06.2020, Kryetari i KLP, Z. Gent Ibrahimi, raportoi në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për veprimtarinë e institucionit për vitin 2019.

Z. Ibrahimi, pasi kreu një pasqyrë të përgjithshme të veprimtarive kryesore të KLP, u përgjigj pyetjeve të anëtarëve të këtij komisioni.

Në përfundim, anëtarët e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut shprehën vlerësimet mbi aktivitetin e KLP, transparencën në vendimmarrje dhe arritjet më të rëndësishme të këtij institucioni, duke përfshirë edhe përfundimin e dy procedurave themelore sikurse ishin, zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm dhe ngritja e Prokurorisë së Posaçme.

Nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, më datë 25.06.2020, u votua projektrezoluta mbi Raportin vjetor të KLP për vitin 2019.

- Emërimi i drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Në zbatim të Ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", Neni 33/2l, ku përcaktohet se:

*Komisioni i përbërë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë të posaçëm me më shumë vite eksperiencë pune si prokuror, pas një procesi rekrutimi të hapur dhe transparent, rekomandojnë një kandidat për Drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit,* ***i cili emërohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë****. Drejtori emërohet për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë.*

KLP miratoi në mbledhjen e datës 30.07.2020, Vendimin "Për emërimin e Drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit znj. Aida Veizaj".

- Takime me përfaqësues të Prokurorive të Rretheve Gjyqësore.

Kryetari i KLP ka zhvilluar takime të njëpasnjëshme me drejtues të Prokurorive pranë Gjykatave të: Gjirokastër, Sarandë, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë, Korçë, Pogradec, Pukë, në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit të KLP me Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe në funksion të përmirësimit të punës së tyre.

- Procedura e komandimit të kandidatëve për Prokuror Ndërlidhës në EUROJUST.

Në kuadër të detyrimeve që lindin në lidhje me marrëveshjen për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST, në përgjigje të thirrjes së datës 24.02.2020, KLP ka administruar dy kërkesa:

- Znj. Fatjona Memçaj, prokurore në Prokurorinë e Apelit në Tiranë;
- Znj. Sonila Muhametaj (Domi), prokurore në Prokurorinë e Tiranës,

kandidate për prokurorë ndërlidhës në EUROJUST.

Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së komandimit me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore.

Më datë 27.07.2020, janë miratuar me shumicë votash opinionet për dy kandidatet, të cilat u publikuan dhe në faqen e internetit të Këshillit.

Këto opinione iu përcollën Prokurorit të Përgjithshëm (më 02.09.2020), duke i kërkuar të shprehet për këto kandidatura dhe për afatet e komandimit.

Më datë 04.09.2020, Prokurori i Përgjithshëm është shprehur se përzgjedh kandidaten Fatjona Memçaj, për pozicionin e Prokurorit Ndërlidhës në Eurojust.

***Njëkohësisht ka kërkuar shtyrjen e procedurave të komandimit, për një periudhë 2 vjet e 6 muaj, deri në njoftimin mbi sigurimin e mbështetjes financiare nga autoritetet përgjegjëse pranë ekzekutivit dhe rezultatet e negociimit mbi përqindjen e financimit nga projekti IPA.***

- Procedurat e verifikimit të kandidatëve për programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Në mbledhjen e datës 17.07.2020, KLP, me Vendimin nr. 167, ka vendosur të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2020 -2021. Gjithsej janë 28 (njëzet e tetë) kandidatë, ku një prej tyre është tërhequr nga gara.

Për ndjekjen e këtij procesi është ngarkuar Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore, si dhe me Vendimin nr. 168, u caktuan me short relatorët për secilin prej kandidatëve.

- *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

**Këshilli i Emërimeve në Drejtësi** (KED), në zbatim të nenit 149/d të Kushtetutës, kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, midis radhëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ata ushtrojnë mandatin e tyre për një vit.

Gjatë periudhës janar – shtator 2020, KED ka zhvilluar **5** mbledhje.

***Mbledhja e parë*** u zhvillua në datë **15.01.2020** me rend dite si më poshtë:

1. Kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me përbërjen e zgjedhur për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për vitin kalendarik 2020.

2. Çështje të mbështetjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me mjete buxhetore, personel administrativ, ambiente dhe pajisje pune nga Gjykata e Lartë për vitin 2020.

3. Informacion për vendet vakante ekzistuese për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të cilat sipas Kushtetutës plotësohen nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë.

4. Procedura e shortit për caktimin e anëtarëve relatorë për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendet vakante si më poshtë:

    - Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo. Pas hedhjes së shortit, u caktua relatore znj.Saida Dollani dhe aktualisht për këtë pozicion vijon procedura për verifikimin e kushteve ligjore.

    - Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj. Pas hedhjes së shortit, u caktua relatore znj.Arta Marku dhe aktualisht për këtë pozicion vijon procedura për verifikimin e kushteve ligjore.

    - Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi. Pas hedhjes së shortit, u caktua relatore znj. Miranda Andoni dhe aktualisht për këtë pozicion vijon procedura për verifikimin e kushteve ligjore.

Gjithashtu, pas organizimit të shortit për caktimin e këshilltarëve ligjorë të ngarkuar me mbështjetjen e veprimeve të relatorëve për dy nga vendet vakante, rezultatet janë si më poshtë:

- Caktimi i z. B. Rrapaj, Këshilltar për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda Andoni lidhur me procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Altin Binaj, Artan Spahiu dhe Gentian Mete, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

- Caktimi i z.**Florjan Kalaja, Këshilltar për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Eugen Papandile, Sonila Bejtja dhe Zhaklina Peto, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

- Caktimi i znj. Laureta Nezaj, Këshilltare për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Arta Marku për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës së kandidatit Besnik Muçi, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj, si dhe për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda

Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Dedë Kasneci dhe Sergjio Mazreku, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

- Caktimi i z. Saimir Nazifi,Këshilltar për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Sinan Tafaj dhe Shaqir Hasanaj, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

***Mbledhja e dytë e KED***u zhvillua më datë **03.02.2020**, gjatë së cilës u diskutuan çështje e mëposhtme:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

5. Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.

***Mbledhja e tretë e KED*** u zhvillua më date **05.02.2020**, gjatë së cilës u vijua me diskutimin e cështjeve të mbledhjes së datës 03.02.2020 dhe në përfundim u miratuan:

1. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;

2. Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”.

***Mbledhja e katërt e KED*** u zhvillua më date **06.02.2020**, gjatë së cilës u vijua me diskutimin e cështjeve të mbledhjes së datës 03.02.2020 dhe në përfundim u miratuan:

1. Projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

2. Projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Gjithashtu, Këshilli ngarkoi Kryetarin që, brenda afatit një mujor, me mbështetjen e këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, të përgatisin dokumentin e projektrregullores së brendshme me objekt detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, kryerjen e veprimeve të ndryshme administrative, krijimin, qarkullimin, ruajtjen dhe mbajtjen e dokumentacionit dhe të regjistrave, të protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve.

***Mbledhja e pestë e KED*** u zhvillua më date **30.06.2020,** gjatë së cilës u diskutuan cështjet e mëposhtme:

1. Diskutime dhe vlerësime në lidhje me rekomandimet e bëra nga Komisioni i Venecias në Opinionin nr.978/2020, datë 19 qershor 2020 “Për Emërimin e Gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese” përsa i takon veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sa i takon pikës së parë të rendit të ditës, KED vendosi të ngrihet një grup pune i përbërë nga anëtarja e KED Znj. Saida Dollani dhe anëtarja zëvendësuese Znj. Marsida Xhaferllari, të cilat do të punojnë intensivisht mbi pasqyrimin e rekomandimeve të bëra nga Komisioni i Venecias në Opinionin nr.978/2020, datë 19 qershor 2020 “Për Emërimin e Gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese” përsa i takon veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Këto rekomandime do të pasqyrohen në aktet rregullatore të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për të bërë të mundur vijimin e procesit në tërësi mbi përzgjedhjen e kandidaturave për vendet vakante
Të tjera që lidhen me vijimësinë e përgatitjes së çështjeve të shortuara.

2. Në lidhje me vijimësinë e përgatitjes së çështjeve të shortuara u bë me dije nga anëtarët relatorë se dy nga vakancat e përkohëshme që i takojnë institucionit të Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë, janë përgatitur plotësisht dhe në një kohë sa më të afërt do t’u përcillen kandidaturave përkatëse. Lidhur me vakancën e tretë që i takon Presidentit të Republikës, nuk është përfunduar ende i gjithë procesi standard i verifikimit.

Në vijim KED raporton se:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vijuar procesin e verifikimit të kandidatëve për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e kushteve formale të parashikuara nga ligji. Konkretisht:

1- Për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datë 21.08.2019, u ndaluan të gjithë kandidatët, si dhe u tërhoqën, gjithashtu është njoftuar organi i emërtesës për rishpalljen e këtij vendi vakant.

2- Për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datë 27.09.2019, u ndaluan të gjithë kandidatët, si dhe u tërhoqën, gjithashtu është njoftuar organi i emërtesës për rishpalljen e këtij vendi vakant.

3- Për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, rezulton:

- Janë ndaluar 6 kandidat
- 1 kandidat është tërhequr dhe është mbyll procedura e verifikimit.
- 1 kandidat është lejuar.
- 2 kandidat janë në proces verifkimi dhe do të merren në shqyrtim ditën e premte datë 09.10.2020.

*Inspektorati i Lartë i Drejtësisë*

Në mbështetje të nenit 147/d e vijues, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kreut IV, të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Zotit Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë" **nga data 1.02.2020, është krijuar institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D).** Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë menjëherë masat e nevojshme për organizimin dhe funksionin e këtij institucioni të ri. Ky proces u shoqërua fillimisht nga ana e ILD me identifikimin e kostove financiare, sigurimin e fondeve buxhetore, hartimin e strukturave organizative të personelit, rekrutimin e stafit, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e tij.

Konkretisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në proces administrimi dhe shqyrtimi fillestar të një volumi të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magjistratëve, të cilat janë dorëzuar gjatë periudhës transitore 2017-2020 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme si dhe institucioneve të tjera. ILD gjithashtu nga data 01.02.2020, datë në të cilën konsiderohet fillimi i veprimtarisë së tij, po administron të gjitha ankesat e paraqitura pranë tij nga ana e personave fizik, ose juridik.

DRAFT

Me qëllim fillimin sa më parë të veprimtarisë së institucionit në mbështetje të nenit 283, pika 7, të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 88, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", Inspektori i Lartë i Drejtësisë me Urdhrin nr.1, datë 07.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së përkohshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratoi strukturën e përkohshme të institucionit me 40 punonjës.

Bazuar në këtë strukturë, u hartuan përshkrimet e pozicioneve të punës dhe më datë 08.02.2020 u shpallën 27 pozicione vakante.

Në të njëjtën kohë, ILD hartoi dhe strukturën përfundimtare, e cila sipas nenit 197, pika 4, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i ndryshuar, u dërgua në datën 06.03.2020 për miratim pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe u miratua nga ky i fundit me vendimin nr. 28/2020, datë 18.06.2020 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".

Deri në datën 13 Mars 2020, ditën kur u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore, institucioni i ILD-së arriti të përfundojë 8 procedura rekrutimi pasi procedurat e tjera u pezulluan për shkak të masave të marra nga Qeveria si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia dhe anulimit të të gjitha procedurave për rekrutimet në shërbimin civil.

Për shkak të kohëzgjatjes së pezullimit të procedurave të rekrutimit si dhe duke marrë në konsideratë faktin se Kuvendi i Shqipërisë ishte në fazën e miratimit të strukturës përfundimtare të propozuar nga ILD, në respektim të parimeve të ekonomisë administrative, të kryerjes në të njëjtën kohë të të gjitha procedurave të rekrutimit për të shmangur mbivendosje të zhvillimit të procedurave të ndryshme për të njëjtin pozicion pune, ILD anuloi procedurat e shpallura dhe vendosi t'i rishpallë sërish ato sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, në përputhje me strukturën, organikën dhe përshkrimet e reja të punës të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillimisht ka ushtruar funksionet e tij pranë ish ambienteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe pas miratimit të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 24.06.2020 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë të godinës së ish- Ministrisë së Integrimit Evropian", duke filluar nga data 9 Shtator 2020, funksionet e Zyrës së ILD-së zhvillohen pranë godinës së Departamentit të Administratës Publike.

Lidhur me emërimet në institucion gjatë muajve Shkurt-Shtator 2020, rezulton si me poshtë:

**Kabineti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-së**
5 këshilltarë; 1 sekretare; 1 ndihmese;

**Inspektorë magjistratë:**
1 inspektore magjistrate

**Niveli i lartë drejtues:**
1 (Drejtor i Përgjithshëm)

**Niveli i mesëm drejtues:**
2 drejtore drejtorie dhe 10 nd/inspektore

**Niveli ulet drejtues:**
4 përgjegjës sektori

**Niveli Ekzekutiv:**
3 specialistë

**Punonjës mbështetës:**
5 punonjës (me Kod Pune)

**Punonjës me kontrate:**
7 punonjës me kontratë

Të gjitha procedurat e rekrutimit të vendeve vakante me kontratë të përhershme të shpallura nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës Prill-Maj kanë qenë të pezulluara bazuar në Urdhrin nr. 351, datë 29.05.2020 "*Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19*" të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Sa i përket emërimeve për pozicioni inspektor pranë ILD-së, bazuar në nenin 209 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", jo më pak se gjysma e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë magjistratë, të cilët komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
Pjesa tjetër e inspektorëve emërohen nga Inspektori I Lartë i Drejtësisë sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr. 69, datë 07.02.2020, ka komanduar përkohësisht si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një periudhë 6 mujore magjistraten znj. Marsela Pepi.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen e datës 26.02.2020, ka vendosur të hapë procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për 6 pozicione inspektor magjistrat, në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pozicion për të cilin nuk ka patur asnjë kandidaturë.
Më datë 10.07.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rihapur serish procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin inspektor magjistrat pranë Zyrës së ILD-së dhe deri tani rezulton se nuk ka asnjë kandidaturë të paraqitur.

Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin nr. 37, datë 05.02.2020, ka shpallur fillimin e procedurës për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes procedurës së komandimit, dhe me vendimin Nr. 77, datë 04.03.2020, ka komanduar Znj. Mirela Kapo, prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Krujë, në pozicionin e ndihmës magjistratit (këshilltar) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka pranuar **6 kandidatura** nga prokurorë për pozicionin inspektor magjistrat dhe aktualisht është në proces të vlerësimit të kandidaturave të paraqitura

Sa i përket rekrutimit të inspektorëve jo magjistratë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministravenr.536, datë 25.7.2019 “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit”, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka shpallur procedurën për pozicionin e Inspektorit jo magjistrat fillimisht **për 6 vende.**

Aktualisht, ILD është në pritje të informacioneve nga institucione të tjera në kuadër të procesit të verifikimit të figurës, integritetit dhe të pasurisë së kandidatëve në fjalë.

Nisur nga përcaktimet ligjore se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore, bazuar në nenin 119 e vijues, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, dhe Ministrisë së Drejtësisë të dërgohen pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

- Ankesat e depozituara nga çdo person fizik, ose juridik lidhur me pretendimin për shkeljet e kryera nga ana e magjistratëve;
- Çdo dosje disiplinore në proces hetimi;
- Çdo problematikë të konstatuar që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave funksionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Çdo çështje lidhur me inspektimet tematike dhe institucionale sipas kërkesave të nenit 194, pika 4, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për periudhën Shkurt- Shtator 2020, janë depozituar:

-**757 ankesa** të marra nga KLGJ si ankesa të prapambetura;
-**174 ankesa** të depozituara nga institucione të tjera ( KLP, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë, Presidenti i Republikës, SPAK, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, gjykata, bashki etj);
-**5 ankesa** nga organizata;
-**569 ankesa** nga qytetarët[1].

Bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj.

Në zbatim të kësaj dispozite, për periudhën Shkurt- Shtator 2020, janë kryer:
-**569 konfirmime** mbi ankesat e depozituara nga qytetarët;

[1] Të përfshira edhe ankesat e përsëritura

DRAFT

-**174 konfirmime** mbi ankesat e depozituara nga institucione të tjera.
- **5 konfirmime** mbi ankesat e ardhura nga organizatat.

Bazuar në nenet 121, dhe 122 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, lidhur me shqyrtimin e ankesave përgjatë periudhës Shkurt-Shtator 2020, janë miratuar:

- **54 vendime** për arkivimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar;
- **54 njoftime** për vendimet e arkivimit të ankesave;
- **19 vendime** për verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar;
- **30 kërkesa** drejtuar gjykatave apo prokurorive, mbi informacione ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve të kërkuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kuadër të verifikimit të ankesave;

Po ashtu, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ( dhe ish-KLD), vetëm në periudhën gusht-shtator, janë depozituar pranë ILD-së **1347**[2] **praktika** (Praktika te inspektimit te ish-KLD**),** për trajtimin e të cilave është ngritur një grup pune me urdhër të Inspektorit të Lartë, i cili do të bëjë trajtimin e tyre sipas urdhrit.

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenet 194/3 dhe 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar **6 vendime për fillimin e hetimit disiplinor,** konkretisht:

- Vendimi nr. 313/7 dt 02.04.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit….";
- Vendimi nr. 251/11 dt 22.05.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurores….";
- Vendimi nr. 664/4 dt 07.07.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit….";
- Vendimi nr. 705/1 dt 2.05.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares….";
- Vendimi nr. 1751 dt 16.07.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares….";
- Vendimi nr. 1752 dt.16.07.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorit….".

Nga këto hetime disiplinore të kryera:

- **2** prej tyre janë hetime disiplinore te iniciuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
- **3** kërkesa për procedim disiplinor për dy magjistratë gjyqtarë dhe një magjistrat prokuror pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bazuar në pikën 4 të nenit 194 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kryen dhe inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me

[2] Praktika të inspektimit të ish-KLD.

shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Në zbatim të kësaj dispozite janë miratuar:

- Vendim Nr. 1 datë 11.02.2020, "Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt "Lirimin me Kusht";
- Vendim Nr. 1/1 datë 20.02.2020 "Për shtimin e objektit të inspektimit tematik të caktuar me vendimin nr. 1 datë 11.02.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë";

o *Procesi i vlerësimit dhe ecuria e institucioneve ri-vlerësuese*

*Komisioni i Pavarur i Kualifikimit*

**Komisioni i Pavarur i Kualifikimit** është organ i ri kushtetues, me mandat 5-vjeçar, i krijuar me ndryshimet e reja të Kushtetutës, si pjesë e paketës për Reformën në Drejtësi, për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 82/2017, datë 17.6.2017, miratoi në bllok listën me 12 komisionerë. Veprimtaria e Komisionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i ligjit është rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve (subjekteve të rivlerësimit) në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni vlerëson çështjet e subjekteve të rivlerësimit në 4 trupa gjykuese me 3 anëtarë secila, bazuar në tre kritere:

a) Vlerësimi i pasurisë;
b) Vlerësimi i figurës;
c) Vlerësimi i aftësive profesionale.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit raporton se për periudhën janar-shtator 2020 ka dhënë 75 vendime gjithsej, nga të cilat:

- 26 vendime konfirmimi në detyrë për 19 gjyqtarë dhe 7 prokurorë;
- 27 vendime shkarkimi nga detyra për 22 gjyqtarë dhe 5 prokurorë;
- 21 vendime për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të 14 gjyqtarëve, 4 prokurorëve, 1 këshilltari ligjor dhe 2 - ish inspektorëve në ish- KLD;
- 1 vendim pezullimi nga detyra të një gjyqtari dhe detyrim për ndjekjen e Shkollës së magjistraturës për 1 vit.

*Kolegji i Posaçëm i Apelimit*

**Kolegji i Posaçëm i Apelimit** vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Apelimit është

DRAFT

organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Deri më 30.09.2020, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar 143 çështje të juridiksionit të rivlerësimit, 40 gjatë vitit 2018, 62 gjatë vitit 2019 dhe 41 çështje deri në 30 shtator 2020. Nga 40 çështje gjatë vitit 2018, 16 janë ankimuar nga Komisioneri Publik dhe 24 nga subjektet e rivlerësimit; nga 62 çështjet e regjistruara gjatë vitit 2019, 11 janë ankimuar nga Komisoneri Publik, 50 nga subjektet e rivlerësimit dhe një çështje është ankimuar edhe nga subjekti i rivlerësimit, edhe nga Komisioneri Publik; nga 41 çështjet e regjistruara deri më 30.09.2020, 9 janë ankimuar nga Komisioneri Publik dhe 32 nga subjektet e rivlerësimit.

Aktualisht, janë duke u shqyrtuar 73 çështje, nga të cilat 6 çështje janë nën gjykim (2 seanca publike dhe 4 dhoma këshillimi), ndërsa 67 çështje janë në përgatitje për gjykim.

Deri në datën 30 shtator 2020, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka shpallur 70 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit, nga të cilat 12 janë shpallur në vitin 2018, 34 janë shpallur gjatë vitit 2019 dhe 24 vendime deri në datën 30.09.2020.

Nga 70 çështje të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vendosur:

i. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – **në 50 vendime (8 janë të vitit 2018) dhe (23 janë të vitit 2019) dhe (19 vendime i përkasin vitit 2020);**
ii. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me përmbajtjen në dispozitiv për, ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare - **në 3 vendime (2 janë të vitit 2018) dhe (1 është i vitit 2019);**
iii. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit - **në 13 vendime (1 vendim është i vitit 2018), (8 vendime janë të vitit 2019) dhe (4 vendime janë të vitit 2020);**
iv. Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra – **në 2 vendime (1 vendim i përket vitit 2019);** prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare – **1 vendim (vendimi është i vitit 2020);**
v. Pushimin e shqyrtimit të çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit nga ankuesi – **në 2 vendime (1 vendim i përket vitit 2018) dhe (1 vendim i përket vitit 2019).**

Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve është parashikuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016; në këtë kuadër, gjatë vitit 2018 janë regjistruar dhe trajtuar 136 denoncime; gjatë periudhës janar 2019 – 31.12.2019, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar dhe trajtuar 340 denoncime; ndërsa për periudhën 01.01.2020 deri më – 30.09.2020 janë regjistruar dhe trajtuar 119 denoncime.

- *Institucioni i Komisionerëve Publikë*

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b të të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, aneksit kushtetues dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Institucioni i Komisionerëve Publikë si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ushtron këto kompetenca*:*

a. Ankimon në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 15 ditë pas njoftimit (neni 63 i ligjit nr. 84/2016).
b. Përgatit raportin me shkrim me arsyet e refuzimit për moszbatimin e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (aneksi kushtetues, neni B “Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit).
c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).

Institucioni i Komisionerëve Publikë drejtohet nga dy Komisionerët Publikë: Z. Florian Ballhysa dhe z. Darjel Sina. Komisionerët Publikë në ushtrimin e detyrës së tyre mbështeten nga: Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga 6 këshilltarë ligjorë dhe 4 këshilltarë ekonomikë, Kancelari dhe Njësia Administrative, e përbërë nga 16 punonjës.

Struktura organizative e Institucionit të Komisionerëve Publikë, është miratuar me Vendimin nr. 94/2017, ndryshuar me Vendimin nr. 102/2018, datë 4.10.2018, të Kuvendit të Shqipërisë.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, për periudhën: **Janar- shtator 2020**, është njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për **71 vendime.** Ndërkohë, në fund të dhjetorit 2019 është njoftuar për **4 vendime** të tjera , të cilat janë shqyrtuar në muajin janar 2020.

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2020, Komisionerët Publikë kanë shqyrtuar gjithsej **69 vendime** dhe **6** prej tyre janë në proces shqyrtimi sipas afateve ligjore. (15 ditë pas njoftimit, referuar nenit 63 i ligjit 84/2016).

Për 69 vendimet e shqyrtuara, Komisionerët Publikë kanë vendosur: **11 Ankime** dhe **58 Mosankime**.

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, gjatë periudhës janar-shtator 2020, u ka paraqitur Komisionerëve Publikë **2 (dy)** Rekomandime me shkrim për të ushtruar ankim.

Në referencë të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, në faqen zyrtare të Institucionit të Komisionerëve Publikë është publikuar formulari i denoncimit dhe kontaktet e specialistit të pritjes me publikun. Denoncimet e publikut regjistrohen në një regjistër të posaçëm dhe merren në shqyrtim nga komisionerët dhe njësia ligjore. Në regjistrin e denoncimeve të publikut, për periudhën: **Janar-shtator 2020**, janë regjistruar **137 denoncime**.

IKP ka miratuar për periudhën Janar-Shtator 2020 aktet nënligjore dhe normative si më poshtë

DRAFT

- Rregullore për "Krijimin dhe administrimin e fashikullit në Institucionin e Komisionerëve Publikë";
- Rregullore mbi "Përcaktimin e masave mbrojtëse të jashtëzakonshme për kufizimin e përhapjes së COVID-19, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Institucionit të Komisionerëve Publikë", miratuar me vendimin nr. 6, datë 8.5.2020, të Mbledhjes së Komisionerëve Publikë.

**Përsa më sipër, Ministria e Drejtësisë** ka lehtësuar procesin e rivlerësimit në tre drejtime kryesore:

- Duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për organet e rivlerësimit;
- Duke siguruar mjetet financiare për organet e rivlerësimit;
- Duke bashkëpunuar me organet e vetingut mbi kërkesat për informacion të paraqitura në kuadër të procesit të rivlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit që po kryhen nga këto organe.

Rezulton se për periudhën janar 2020 – shtator 2020, në Ministrinë e Drejtësisë janë administruar **157** shkresa të ardhura nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ku kanë kërkuar informacion nga Regjistri Elektronik i Noterëve (RNSH) për veprimet noteriale të kryera pranë zyrave noteriale të Republikës së Shqipërisë, nga subjektet e rivlerësimit.

Pas kërkimeve në RNSH, për secilën kërkesë, Ministria e Drejtësisë ka vënë në dispozicion listën e noterëve ku subjekti ka kryer veprime noteriale, në bazë të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë ".

DRAFT

## 2.2 IMPAKTI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË NË PËRPUTHJE ME AXHENDËN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Aderimi në Bashkimin Evropian është një nga pikësynimet më të madha të shtetit shqiptar, i cili vazhdon punën për të përmbushur kriteret e nevojshme dhe për të garantuar respektimin e parimeve thelbësore në fushën e drejtësisë, si pika bazë për ndërtimin e një shteti ligjor.

Në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë parashikuara masa duke mbajtur në konsideratë *acquis* e Bashkimit Evropian për kapitullin 23, e konkretisht me nënfushën e gjyqësorit, si dhe në përputhje me rekomandimet e raportit të Progresit të Komisionit Evropian. Rrjedhimisht, implementimi i masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë ecën në mënyrë paralele me agjendën e integrimit në Bashkimin Evropian dhe ndihmon në shtytjen përpara të proceseve të integrimit dhe përmbushjen e kritereve thelbësore dhe të nevojshme për funksionimin si një shtet me parime Evropiane.

Gjithashtu Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë është në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për sa i përket përmbushjes së 5 prioriteteve lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider për prioritetin 2 "Sistemi Gjyqësor", prioritetin 3 "Lufta kundër korrupsionit", si dhe institucion kontribues për prioritetin 5 "Mbrojtja e të drejtave të njeriut", ka ndjekur dhe koordinuar punën më të gjithë aktorët lidhur me adresimin e rekomandimeve të progres raportit të Komisionit Evropian për vitin 2019.

Në mënyrë periodike ka vijuar përditësimi i Planit të Veprimit për 5 Prioritetet e Komisionit Evropian, për vitin 2019 dhe në vijim, monitorimi i rekomandimeve të Nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë, për të cilat Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse si dhe monitorimi dhe përditësimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2020-2022, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve dhe arritjen e standarteve të nevojshme në fushën e drejtësisë, për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian.

Ministria e Drejtësisë, duke vlerësuar si jetik procesin e zbatimit të Reformës në Drejtësi, për një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe transparent, vazhdon të ofrojë mbështetjen maksimale për realizimin me sukses të kësaj reforme duke dhënë kontributin e saj në funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

DRAFT

## 2.3 KOMPONENTËT QË KANË NEVOJË PËR ADRESIMIN ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E IMPLEMENTIMIT

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2019 - 2021, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- Gjithëpërfshirja e aktorëve të sistemit të drejtësisë dhe grupeve të interesit gjatë fazave të raportimit, konsultimit dhe monitorimit.
- Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse, nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.
- Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.

DRAFT

## 2.4 EKZEKUTIMI I PËRGJITHSHËM I BUXHETIT

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për vitet 2017 - 2021 për Reformën e Sektorit të Drejtësisë ishte vlerësuar në 98,385,653 Euro. Në kuadër të thellimit të angazhimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe reflektimin e saj në zbatimin e Planit të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën 2019 - 2021. Në vijim, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 409, datë 19.06.2019 miratoi Planin e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Përsa i përket kostove të parashikuara në Planin e Veprimit për vitet 2019 – 2021, rezulton se:

- 3.165.677 (në mijë lekë) mbulohen nga buxheti i shtetit;
- 5.830.122 (në mijë lekë) mbulohen nga donatorët[3].




Në kuadër të monitorimit të zbatimit të masave të Planit të Veprimit 2019 - 2021, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi shpenzimet në bazë të aktivitetit të kryer.

[3] Buxhetimi i masave të profesioneve të lira ligjore do të mbulohet nga të ardhurat e vetë Dhomave, si ente private me vetëfinancim.

## III. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE SPECIFIKE & MASAVE

Arritjet kryesore më të rëndësishme, në zbatim të Planit të Veprimit 2019 – 2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë si më poshtë vijon:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor, në datën 5 shkurt 2020, në bashkëpunim të ngushtë me USAID, bëri aktive *faqen e re të internetit* (www.klgj.al). Faqja e re veçse përmbush detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", synon vendosjen e marrëdhënieve proaktive, transparente e informuese me publikun dhe median.

- Këshilli ka miratuar dhe vënë në funksionim një numër aktesh rregullatore që synojnë përmirësimin e eficiencës dhe të pavarësisë së gjykatave si: skema e delegimit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera, zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave etj. Gjatë gjashtë - mujorit të parë të vitit 2020, Këshilli ka trajtuar **268 kërkesa për caktim gjyqtari** gjithsej, në përgjigje të të cilave janë caktuar **400 gjyqtarë** për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

- Pas përfundimit të procedurave të kandidimit për secilin nga pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e lartë, pas verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për të gjithë konkurrentët, si dhe vlerësimin sipas meritave të kandidatëve të kualifikuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 110, 111 dhe 112 datë 27.2.2020, vendosi t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e tre kandidatëve. Me dekretet nr. 11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020, të Presidentit të Republikës, u emëruan në Gjykatën e Lartë, gjyqtarët S.Sadushaj, E.Pupe dhe I. Panda.

- KLGJ, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për periudhën Janar – Shtator 2020 kanë organizuar 111 ***shorte*** për përzgjedhjen e dosjeve për **111 subjekte të rivlerësimit kalimtar.** Janë depozituar pranë KPK-së dhe ONM-së **40 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara**, të shoqëruara me **200 dosje gjyqësore për 40 subjekte rivlerësimi** si dhe janë në proces dorëzimi (të përfunduar) **12 raporte të tjera**. Gjithësej, duke marrë parasysh edhe punën e realizuar që nga momenti i krijimit të organeve të pavaruara të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, deri më 30 qershor 2020 janë dorëzuar pranë KPK dhe ONM **250 raporte vlerësimi**.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor për të mbështetur ri-funksionimin e Gjykatës së Lartë ka miratuar Memorandumin e Mirëkuptimit mes KLGJ dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

- KLGJ, në përputhje me objektivin nr. 3 të Planit Strategjik të KLGJ "Sigurimi i mirëfunksionimit të gjykatave, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave", miratoi me vendimin Nr. 316, datë 14.09.2020 rregulloren për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ky akt normativ përcakton elementet kryesore procedurale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore.

DRAFT

- Këshilli, me vendimet 170 dhe 171, datë 28.05.2020 vendosi ngritjen dhe përbërjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të inspektorit të lartë të drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që janë objekt i Komisionit, do të bëhet për të gjitha ankimimet e regjistruara gjatë vitit 2020, duke ndjekur, radhën e regjistrimit.

- KLGJ në bashkëpunim me Projektin Justice for All, është duke punuar për krijimin e një portali elektronik të unfikuar të sistemit gjyqësor ku KLGJ dhe të gjitha gjykatat do të kenë faqen e tyre të dedikuar. Ky portal do të mundësojë një transparencë më të mirë të veprimtarisë gjyqësore të gjykatave.

- Në kuadrin e **rritjes së transparencës së vendimmarrjes** në procesin e emërimeve / promovimeve të gjyqtarëve, kriteret dhe metodologjia e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve është publikuar në faqen zyrtare të KLGJ: konkretisht kategoria e vendimeve me karakter normativ: http://klgj.al/akte-normative-nënligjore/.

- KLGJ ka bërë të mundur blerjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike nga të gjitha gjykatat sipas parashikimeve buxhetore.

- **KLP** pasi shpalli me Vendimin nr. 19, datë 27.01.2020[4], njoftimin për plotësimin e dy vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme, kriteret që duhet të plotësonin kandidatët për prokuror u publikuan në faqen zyrtare të internetit të KLP. Kandidatët që shprehën interesin, paraqitën dokumentacionin përkatës dhe me Vendimin nr. 84, datë 18.03.2020, KLP miratoi listën e kandidatëve për prokurorë, të cilët plotësojnë kushtet ligjore, pas vlerësimit paraprak. Numri i kandidatëve që vijoi garën ishte 4 (katër). Ndërsa, me Vendimin nr. 92, datë 10.04.2020, KLP shpalli fillimin e procedurave të ngritjes në detyrë për një pozicion vakant në SPAK, si dhe caktoi Komisionin e Posaçëm që do të zhvillojë procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve. Me Vendimin nr. 113, datë 15.05.2020, KLP vendosi bashkimin e procedurave administrative, lidhur me vendimet e sipërpërmendura. Sipas këtij vendimi, vlerësimi përfundimtar dhe renditja e katër kandidatëve kualifikuar të jetë e vlefshme për plotësimin e tre vendeve vakante, për prokuror të SPAK. Pasi u njoh me raportin përfundimtar për katër kandidatët, nga ana e kryetarit të Komisionit të Posaçëm, KLP kreu pikëzimin përkatës e në këto kushte Këshilli vendosi të emërojë prokuror në SPAK Z. Sotir Kllapi, Z. Dritan Prençi dhe Z. Vladimir Mara për një mandat 9 (nëntë) vjeçar, pa të drejtë riemërimi, të cilët më datë 21.05.2020, kryen betimin para Presidentit të Republikës. **Tashmë, SPAK përbëhet nga 13 anëtarë.**

- Në zbatim të Ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", Neni 33/21, KLP miratoi në mbledhjen e

[4] Ndryshuar me Vendimin nr. 54, datë 24.02.2020, sa i përket afatit të shprehjes së interesit, nga 15 ditë në 40 ditë.

datës 30.07.2020, **Vendimin "Për emërimin e Drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit znj. Aida Veizaj**".

- Për çështje që lidhen me veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, KLP ka vijuar me miratimin e një sërë vendimesh.

- Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në KLP, në mbështetje të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit , për janar-shtator 2020, janë kryer **41 Raporte për analizimin e aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit (prokuror).**

- Në funksion të realizimit të masës që ka parashikuar Funksionimin e plotë të KLGJ-së e KLP-së me kuadrin rregullator, kapacitetet dhe infrastukturën e nevojshme për të përmbushur funksionin , KLGJ në total nga momenti i miratimit të strukturës deri në 30 qershor 2020, raporton se struktura është plotësuar në masën **76%** (95 punonjës nga 125 të miratuar). Kjo ka mundësuar rritjen e efikasitetit në cdo njësi, si dhe duke rritur cilësinë e përpunimit të akteve, shkresave, si dhe përmirësim e ndjeshëm të afateve kohore të realizimit të këtyre detyrave. Megjithatë, nevoja për burime njerëzore nuk është adresuar plotësisht, për shkak se infrastruktuara aktuale nuk krijon mundësinë që KLGJ të funksionojë me një strukturë të plotë. Procesi i rekrutimeve për të përmbushur strukturën e miratuar të KLGJ-së me 125 punonjës dhe për pasojë funksionimin e saj me kapacitet të plotë, do të vijojë me intensivisht në momentin e transferimit tek mjediset e Polit të Drejtësisë, ku do të sigurohen hapësirat e nevojshme të punës, ndërsa nga ana e KLP raportohet se Që prej muajit Qershor 2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë po e kryen aktivitetin e tij pranë Godinës "Poli i Drejtësisë", duke plotësuar kushtet dhe infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur funksionin.Organigrama e miratuar nga Këshilli i Ministrave ka një numër prej 65 punonjësish. Për periudhën Janar- Shtator 2020 ka përfunduar procedura e rekrutimit të 12 nëpunësve civilë, si dhe janë kryer 3 rekrutime jashtë shërbimit civil.

- Në mbështetje të nenit 147/d e vijues, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kreut IV, të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Zotit Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë" nga data 1.02.2020, është krijuar institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D), duke shënuar kështu një hap shumë të rëndësishëm në zbatimin e reformës në drejtësi.

- Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë menjëherë masat e nevojshme për organizimin dhe funksionin e këtij institucioni të ri. Ky proces po shoqërohet nga ana e ILD me identifikimin e kostove financiare, sigurimin e fondeve buxhetore, hartimin e strukturave organizative të personelit, rekrutimin e stafit, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e tij.

DRAFT

- Bazuar në nenin 121, paragrafi 2, shkronja b), dhe 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 214 ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, lidhur me verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar, përgjatë periudhës shkurt shtator 2020, rezulton të jenë miratuar rreth **19 vendime** mbi verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar; rreth **54 vendime** mbi arkivimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar; rreth **30 kerkësa** drejtuar gjykatave apo prokurorive, mbi informacione ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve të kërkuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kuadër të verifikimit të ankesave; rreth **54 njoftime** mbi vendimet e arkivimit të ankesave; si dhe bazuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenet 194/3 dhe 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar **6 vendime për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë.**

- Gjykata Kushtetuese ka vijuar procesin e trajnimeve dhe kualifikimeve për ngritjen e kapaciteteve këshilluese të vendimmarrjes dhe të stafit nëpunës civil në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të GJK, të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi.

- Në lidhje me reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, që përkon edhe me msaën nr. 3 të nënobjektivit 1/a, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin Nr.317 datë 19.12.2019, ka miratuar ngritjen e një komisioni të përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh. Përballë numrit të jashtëzakonshëm dhe kohës së gjatë të çështjeve në pritje për t’u shqyrtuar dhe në respektim edhe të kritereve ligjore për gjykimin e tyre, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve vlerësoi se do të vijohet menjëherë me shqyrtimin e rekurseve të çështjeve të themelit, nisur nga kriteri i kohës së paraqitjes së tyre për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, krahas çështjeve të tjera që për nga natyra e tyre dhe sipas ligjit duhet të shqyrtohen në mënyrë të shpejtë, sikurse janë mosmarrëveshjet për juridiksionin, kompetencën, kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve.

- Gjykata e Lartë, Në zbatim të dispozitave ligjore për organizimin e Gjykatës së Lartë, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, duke qenë një nga strukturat drejtuese brenda gjykatës, u mblodh për të diskutuar organizimin e Kolegjeve të Gjykatës. Pas vlerësimit të mendimit të shprehur nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Këshilli i Gjykatës vendosi për emërimin e gjyqtarëve në përbërjen e Kolegjeve të Gjykatës dhe emërimin e gjyqtarëve në përbërjen e trupave gjykues (Vendimet nr. 1 dhe nr.2, datë 09.04.2020 të Këshillit të Gjykatës). Që nga momenti i emërimit e deri më tani, Kolegjet e Gjykatës së Lartë kanë vazhduar rregullisht me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, sipas kompetencave përkatëse. Bazuar në të dhënat statistikore të përpunuara nga administrata e Gjykatës së Lartë, për periudhën Prill - 9 Korrik 2020, Kolegjet e Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar **në total 866 cështje**, nga të cilat: **400 çështje administrative**; **216 çështje penale** dhe **250 çështje civile** (ku përfshihen: shqyrtimi gjyqësor i themelit të çështjes, përcaktimi i juridiksionit dhe kompetencës, masa sigurie, kërkesa për pezullim / revokim të vendimit të gjykatave më të ulëta etj).

- Ka përfunduar procesi i vënies në funksionim të Gjykatave të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe funksionimi i tyre është shpallur me vendim Nr. 286 datë 18.12.2019. KLGJ ka caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 1 gjyqtar. Ndërsa, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar ka caktuar në mënyrë të përhershme 4 gjyqtarë, si dhe në mënyrë të përkohshme 6 gjyqtarë.

- Ministria e Drejtësisë, në lidhje me realizimin e masës, "Krijimi i qendrës së centralizuar të mbështetjes së funksionimit të TIK (ITOSC) që do të qeverisë sistemet TIK të gjykatave, KLGJ, KLP, ILD." ,përmes Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit ka hartuar projektvendimin "Për krijimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë". Aktualisht projektvendimi i është nënshtruar procesit të konsultimit të brendshëm (ministritë e linjës dhe organe të administratës publike), janë mbajtur disa takime me përfaqësues të Euralius dhe Justice for All, me synimin e dakordësimit të një drafti.

- Miratimi i ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", ka si qëllim edhe garantimin e rehabilitimit social dhe riintegrimit në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike të të paraburgosurve dhe të dënuarve madhorë dhe të mitur, duke iu garantuar këtyre të fundit format e motivimit nxitës në përputhje me parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit, ndihmën sociale, edukative, arsimore, psikologjike dhe fizike në përputhje me nevojat individuale dhe në përputhje me grup-moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, në funksion kjo edhe të përmbushjes së objektivave të strategjisë, një angazhim ky primar i Ministrisë së Drejtësisë.

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve raporton se Çështja e mbipopullimit në nivel të përgjithshëm në sistemin e burgjeve është një problematikë e zgjidhur. Kapacitet totale të sistemit të burgjeve janë 6106 vende dhe gjatë janar-shtator 2020 janë trajtuar mesatarisht 4985 persona, prej të cilëve 282 shtetas me masë mjekësore mjekim i detyruar. Niveli i popullimit në fund të muajit shtator 2020 ka qenë mesatarisht -18% (-1121). Pra, sistemi i burgjeve në nivel të përgjithshëm ka qenë në kushtet e nënpopullimit.

- Gjatë periudhës raportuese nga Shërbimi I Provës  është përfunduar rikonstruksioni i godinës ku kryen aktivitetin DPSHP dhe ZVSHP Tiranë. Janë krijuar kushtet optimale pasi janë marë 9 zyra me qera, duke patur parasysh se ambientet ku zhvillonin veprimtari këto zyra ishin jo të përshtatshme. Zyrat aktuale të cilat janë marë me qera ofrojnë kushte bashkohore, janë të pajisuara me ambiente dhe bazë material të cilat i përshtaten punës që kryen Shërbimi i Provës duke siguruar një shërbim më cilësor të mbikëqyrjes dhe përkujdesin e të dënuarve.

- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas raporton se janë ngritur dhe funksionojnë **5 Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, përkatësisht në qytetet e Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Fierit, dhe Lezhës në bashkëpunim ndërmjet MD, UNDP dhe OSFA. Gjithashtu,

DRAFT

Ministria e Drejtësisë është në përfundim të procesit të hapjes së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore për qytetin e Lushnjës.

- Në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e pandemsë (Covid-19), u mbyllën qendrat e ndihmës parësore, dhe një pjesë e procesve të punës u pezulluan, duke qënë një shërbim ngushtësisht i lidhur me qytetarin, kurrësesi ndihma juridike nuk mund të mos ofrohej dhe në këto kushte kufizimi.

- Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al.** Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me gjithë legjislacionin e miratuar në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

- Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin SOROS kanë vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën do të kenë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas sidomos gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime sa më pranë qytetarit. Si platforma ashtu edhe numri i gjelbër po vijojnë të funksionojnë në shërbim të çdo qytetari duke krijuar kështu një garanci të shtuar për sigurimin e aksesit të barabartë në drejtësi.

- Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, Ligjit nr.111/2017.Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenin 8 të ligjit Nr. 111/2017, gërma k) DNJF lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore. DNJF ka vijuar me lidhjen e kontratave me avokatët e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për vitin 2020. Lista e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike falas është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe aktualisht, për vitin 2020 kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore **73 avokatë**. Totali i vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike për janar – shtator 2020 është **105 vendime.**

- Lidhur me **trajnimet e gjyqtarëve** dhe avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore, ky aktivitet vijon të jetë në proces dhe janë parashikuar në zbatim të tij zhvillimi i disa tryezave të përbashkëta me aktorët e përfshirë, përkatësisht me Shkollën e Magjistraturës, Dhomën e

Avokatisë së Shqipërisë dhe ASPA-n. Me këto institucione do të bashkëpunohet në funksion të programeve trajnuese mbi ndihmën juridike falas.

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në funksion të rehabilitimit dhe ri-integrimit të të burgosurve që konsiderohet edhe si thelbi i misionit të sistemit të burgjeve ka ndërmarrë masa të vazhdueshme për të bërë të mundur zbatimin e një regjimi kuptimplotë aktivitetesh për këtë kategori.
    - Për periudhën janar shkurt 2020 janë punësuar mesatarisht në sistemin e burgjeve **574** të burgosur prej të cilëve **138** të paraburgosur.
    - Kurset profesionale janë ofruar në 9 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga **287** të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), pikturë, pirografi, elektricist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, rrobaqepësi, punë me dru dhe saldatim.
    - Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën aktivitete të tjera edukuese në të gjithë sistemin e burgjeve është **2756** për periudhën janar shkurt 2020.
    - Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht **192** tema sociale në muaj dhe **37** recensione librash, si dhe janë zhvilluar **365** aktivitete ri-integruese.
    - Është në zbatim një dokument politikash për trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve sipas nevojave të tyre, si dhe programe edukuese për të burgosurit në prag lirimi. Qëllimi i këtyre programeve është ri-integrimi i suksesshëm në shoqëri i të burgosurve dhe parandalimi i sjelljeve recidiviste. Këto kurse janë ndjekur nga **22** të burgosur.

- Si rezultat i zbatimit të Ligjit Nr.5/2020 "Për Dhënie Amnistie", krahasuar me vitin 2019, niveli i popullimit të burgjeve është ulur me 5%. Për zbatimin e këtij ligji janë marrë masat e duhura dhe të nevojshme për efektivitetin e aplikimit të tij në mënyrë sa më rigoroze, në të gjitha IEVP-të.

- Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Qendrën Hollandeze të Studimeve dhe Trajnimit Gjyqësor (SSR) dhe Misionin Euralius V, pas miratimit të kurrikulës mësimore të vitit të parë të Programit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarë ndihmës ligjorë, ka filluar procesin e përmirësimit të kurrikulës mësimore të vitit të dytë të Programit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë.

- Shkolla e Magjistraturës, për periudhën raportuese, ka botuar **1 numër të Revistës "Jeta juridike",** konkretisht nr. 3 të vitit 2019, në 300 kopje.

- Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë**,** pranë Kryeministrisë me qëllim rritjen e kapaciteteve brenda ministrive të linjës, ka koordinuar me ministritë për zgjerimin e Rrjetit të Përhershëm të RIA-s, duke shtuar numrin e anëtarëve nga cdo ministri, ku padyshim përfshihet dhe Ministria e Drejtësisë. Në muajin shkurt 2020 janë organizuar me mbështetjen e ekspertëve të asistencës teknike të BE-së, **4 (katër) seksione trajnimesh** për këtë proces, me pjesëmarrjen e pothuaj të gjithë anëtareve të Rrjetit të RIAs. Ky proces do të vijojë.

DRAFT

- Gjithashtu ky departament në kuadër të menaxhimit dhe bashkërendimit për funksionalizimin e Sistemit të Informacionit (IPSIS) me qëllim rritjen e cilësisë së politikbërjes dhe respektimin e parimeve të planifikimit të integruar, përdorimin më të mirë të burimeve, rritjes së performancës dhe llogaridhënies ka vijuar aktivitetet në vijimësi me qëllim implementimin e sistemit.

DRAFT

## 3.1 VLERËSIMI SIPAS SECILIT OBJEKTIV DUKE PËRDORUR TREGUESIT

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së secilit objektiv të Strategjisë dhe pasqyron grafikisht statusin e zbatimit të Strategjisë për periudhën janar – shtator 2020[5].

### Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 1

| Janar – Shtator 2020 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 1** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 1** |
| Të realizuara | 6 | 46% |
| Në proces | 7 | 54% |
| Të parealizuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **13** | **100%** |







[5] Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është pasqyruar në aneksin 1 të Raportit të Monitorimit.

***Rezulton se nga 13 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 1, janë realizuar 6 prej tyre dhe janë ende në proces zbatimi 7 prej tyre.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektiv, është në nivelin 46% për masat të cilat janë të realizuara dhe 54% për masat në proces zbatimi.

## Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 2

| Janar – Shtator 2020 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 2** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 2** |
| Të realizuara | 0 | 0% |
| Në proces | 4 | 100% |
| Të parealizuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **4** | **100%** |






***Rezulton se nga 4 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 2, të katërta janë në proces zbatimi.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 100% për masat në proces.

**Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasistetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane**.

<u>Numri i masave në zbatim sipas objektivit 3</u>

| **Janar – Shtator 2020** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 3** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 3** |
| Të realizuara | 3 | 60% |
| Në proces | 2 | 40% |
| Të parealizuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **5** | **100%** |

DRAFT







***Rezulton se nga 5 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 3, janë realizuar 3 prej tyre dhe janë ende në proces zbatimi 2 prej tyre.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektiv është në nivelin 60% për masat e realizuara, dhe 40 % për masat në proces.

**Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.**

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 4

| **Janar – Shtator 2020** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 4** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 4** |
| Të realizuara | 2 | 50% |
| Në proces | 2 | 50% |
| Të parealizuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **4** | **100%** |







***Rezulton se nga 4 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 4, janë realizuar 2 prej tyre, janë ende në proces zbatimi 2 prej tyre.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 50% për masën e cila është e realizuar, 50% për masat në proces.

## Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 5

| Janar – Shtator 2020 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 5** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 5** |
| Të realizuara | 1 | 9% |
| Në proces | 6 | 55% |

| | | |
|---|---|---|
| Të parealizuara | 4 | 36% |
| **Totali** | **11** | **100%** |







***Rezulton se nga 11 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 5, është realizuar 1 prej tyre, janë në proces zbatimi 6 masa dhe 4 masa rezultojnë si masa të parealizuara nga institucionet përgjegjëse prej tyre.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 9% për masat të cilat janë të realizuara, 55% për masat në proces dhe 36% për masat të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

## Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

<u>Numri i masave në zbatim sipas objektivit 6</u>

| **Janar – Shtator 2020** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 6** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 6** |

| | | |
|---|---|---|
| Të realizuara | 3 | 60% |
| Në proces | 2 | 40% |
| Të parealizuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **5** | **100%** |







***Rezulton se nga 5 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 6, janë realizuar 3 prej tyre dhe janë ende në proces zbatimi 2 prej tyre.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektiv është në nivelin 60% për masat të cilat janë të realizuara dhe 40% për masat në proces.

## Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 7

| Janar – Shtator 2020 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 7** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 7** |
| Të realizuara | 1 | 9% |
| Në proces | 9 | 82% |
| Të parealizuara | 1 | 9% |
| **Totali** | **11** | **100%** |







***Rezulton se nga 11 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 7, është realizuar 1 prej tyre dhe janë ende në proces zbatimi 9 prej tyre, si dhe1 masë rezulton si masë e parealizuar prej tyre.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit

2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 9% për masat të cilat janë të realizuara, 82% për masat në proces dhe 9% për masën e cilat do të zbatohet në vijim nga institucioni përgjegjës.

## Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.

<u>Numri i masave në zbatim sipas objektivit 8</u>

| Janar – Shtator 2020 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 8** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 2** |
| Të realizuara | 3 | 25% |
| Në proces | 8 | 67% |
| Të parealizuara | 1 | 8% |
| **Totali** | **12** | **100%** |






***Rezulton se nga 12 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 8, janë realizuar 3 prej tyre, 8 prej tyre janë ende në proces zbatimi, si dhe 1 masë është e parealizuar.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektiv është në nivelin 25% për masat të cilat janë të realizuara, 67% për masat në proces, si dhe 8% për masën e cila do të zbatohet në vijim nga institucioni përgjegjës.

DRAFT

## 3.2 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane mbetet misioni i kësaj strategjie.

Gjatë kryerjes së procesit të monitorimit janë evidentuar disa problematika që vlerësohen se kanë ndikuar në nivelin e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Ndër elementët më të rëndësishëm të cilët kanë ndikuar në realizimin e masave të parashikuar në Planin e Veprimit janë si më poshtë:

- Vijon të mbetet problematike përgjegjshmëria e institucioneve për të raportuar me cilësi lidhur me implementimin e Planit të Veprimit 2019 - 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, pavarësisht të gjithë orientimeve të dhëna.
- Mosdërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit, prej shumicës së institucioneve, ndikon në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë.
    - Institucionet kanë raportuar se hasin vështirësi në raportim lidhur me:
        - buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga donatorët (informacion i cili nuk disponohet nga të gjitha pikat e kontaktit pranë institucioneve raportuese);
        - buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga buxheti i shtetit duke u dhënë shpesh herë argumentimi se kryerja e vperimeve të caktuara në zbatim të realizimit të masave të PV, përfshihet në vetë përshkrimin e punës të specialistëve përkatës rrjedhimisht nuk mund të raportohet si kosto.

| *Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë* <br> *Nën-objektivi 1/a: Pavarësia e institucioneve të sistemit të drejtësisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane* | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masat / Aktivitetet e parashikuara** | **Institucioni Përgjegjës** | **Targeti Milestones 2020** | **Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 – 2021** | | **Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)** | | **Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020** *(E realizuar/në proces/ e parealizuar)* | **Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020** |
| | | | **PBA** | **Donatorë** | **PBA** | **Donatorë** | | |
| 1. Hartimi i bazës nënligjore për përcaktimin e kritereve dhe standardeve të meritokracisë dhe transparencës në emërimet dhe promovimet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe administratës gjyqësore. | KLGJ, KLP | Zbatimi i standardeve | | 7 400 | | | Në proces | **Këshilli i Lartë Gjyqësor** <br> Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” përcaktoi rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. <br> Rregullat e këtij vendimi janë të zbatueshme për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë dhe që përmbushin kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në: <br> a) Gjykatën e Lartë; <br> b) Gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar; <br> c) Gjykatën Administrative të Apelit <br> ç) Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. <br><br> Një tjetër element i rëndësishëm për karrierën e gjyqtarëve është edhe plotësimi i kuadrit nënligjor për krijimin e skemës së vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve. Në këtë kuadër janë hartuar edhe aktet nënligjore për realizimin e këtij procesi me synim (i) përmirësimin e vazhdueshëm të aspektit etik dhe profesional të gjyqtarëve; (ii) vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve; (iii) zhvillimin e karrierës së gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale, si dhe (iv) identifikimin e nevojave për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues.<br><br>• vendimi nr. 263, datë 21.11.2019 "për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve"<br>• vendimi nr. 264, datë 21.11.2019 "për miratimin e metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit"<br>• vendimi nr. 316, datë 19.12.2019 "për miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve"<br>• vendimi nr. 120, datë 05.03.2020 "për miratimin e formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit"<br>• vendimi nr. 197, datë 11.06.2020 "për miratimin e rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit". Vendimi është pjesë e Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve dhe synon që nëpërmjet shortimit elektronik të çështjeve të sigurojë transparencën dhe eficiencën maksimale të procesit.<br><br>Programi i Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve për vitin 2020 është miratuar nga KLGJ dhe parashikon vlerësimin e 121 gjyqtarëve përgjatë vitit 2020.<br><br>Këshilli, me vendimin nr. 198, datë 11.06.2020 (18 gjyqtarë) dhe me vendimin nr. 233, datë 02.07.2020 (3 gjyqtarë), filloi procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe caktoi relatorin dhe nëpunësin përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar. Aktualisht ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për gradimin e 21 (njëzetenjë) gjyqtarëve;<br><br>Duke marrë në konsideratë që një nga qëllimet më të rëndësishme për të cilat ndërmerret vlerësimit të |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | gjyqtarëve është ngritja në detyrë e tyre, KLGJ, me vendimet nr. 247 datë 09.07.2020 dhe nr. 314, datë 14.09.2020, “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019”, ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për 24 gjyqtarë, vlerësim i cili do të bazohet në veprimtarinë gjyqësore të vitit të fundit.<br><br>**Këshilli i Lartë i Prokurorisë**<br>KLP, raporton se gjatë periudhës janar-shtator 2020 është miratuar:<br>- Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë”.<br>- Rregullorja “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”.<br><br>Dhe janë në proces:<br>- Rregullorja “Për komandimin e magjistratit në një institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë”.<br>- Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit të juridiksionit të përgjithshëm”.<br>- Rregullorja “Mbi rregullat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve”.<br>- Rregullorja “Për mënyrën e kompensimit për orët shtesë të punës të kryera nga nëpunësit civilë të prokurorisë”.<br><br>- Rregullorja “Për përcaktimin e procedurave të zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj magjistratëve prokurorë”.<br><br>- Rregullore për vlerësimin e performancës në punë të prokurorëve. |
| 2. Hartimi dhe vënia në funksionim e një platforme/ metodologjie/praktike | KLGJ, KLP | | | 700 | | | Në proces | **KLGJ**<br>KLGJ, në bashkëpunim me Bankën Botërore, ka nisur zbatimin e një sondazhi që do të shtrihet në të |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| (pyetësor, sondazhi online etj) për monitorimin periodik të perceptimit të magjistratëve mbi pavarësinë e brendshme të gjyqësorit. | | | | | | | | gjithë sistemin gjyqësor, dhe që ka në fokus verifikimin e parametrave të efiçencës, pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit.<br><br>Si pasojë e situatës së fatkeqësisë natyrore në vend COVID-19, zhvillimi i sondazhit pësoi një shtyrje në kohë, por aktualisht po zhvillohet faza e testimit online.<br><br>**KLP**<br>Në zbatim të Projektit "Albania- Regional perceptions of Justice Survey", të Bankës Botërore, mbështetur nga IPSOS dhe Bashkimi Europian, KLP ka nënshkruar Letrën Mbështetëse për zhvillimin e një pyetësori lidhur me perceptiminin dhe përvojën e shërbimeve të drejtësisë.<br>Në pyetësor do të marrin pjesë gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe publiku i gjerë dhe grupe të tjera që kanë eksperienca në sistemin e drejtësisë.<br>Pyetësori është i fokusuar në disa aspekte: efikasiteti, cilësia e punës, qasja ndaj sistemit gjyqësor/prokurorial, pavarësia e sistemit, reformat në drejtësi dhe çështjet gjinore.<br>Për shkak të Pandemisë Covid19, implementimi i këtij projekti është realizuar pjesërisht, vetëm nëpërmjet plotësimit të një pyetësori online. Mbledhja e të dhënave të këtij pyetësori do të realizohet edhe manualisht, në momentin kur situata e pandemisë të qetësohet. |
| 3.Rritja e transparencës së vendimmarrjes në procesin e emërimeve / promovimeve të gjyqtarëve. | KLGJ | | | 10 000 | | | Realizuar | **KLGJ**<br>Në kuadrin e rritjes së transparencës së vendimmarrjes në procesin e emërimeve / promovimeve të gjyqtarëve, kriteret dhe metodologjia e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve është publikuar në faqen zyrtare të KLGJ: konkretisht kategoria e vendimeve me karakter normativ: http://klgj.al/akte-normative-nënligjore/ ku gjenden:<br>• vendim nr.22 datë 7.02.2019 "mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit te skemës së delegimit të gjyqtarit"<br>• vendim nr.23 datë 7.02.2019 mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit i, ndryshuar |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | • vendim nr.30 datë 14.02.2019 mbi miratimin e vendimit për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në menyrë të përhershme , i ndryshuar<br>• vendim nr.75 datë 23.05.2019 për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë<br>• vendim nr.263 datë 21.11.2019 për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve<br>• vendim nr.264 për miratimin e “metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”<br>• vendim nr.316 datë 19.12.2019 për miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve<br>• vendim nr.70 datë 07.02.2020 mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve<br>• vendim nr. 120, datë 05.03.2020 për miratimin e formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit<br>• vendim nr. 197, datë 11.06.2020 për miratimin e “rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”<br>• vendim nr.316, datë 14.09.2020 për miratimin e rregullores për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”<br>• vendim nr. 320, datë 17.09.2020 për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve<br><br>Gjithashtu, jane publikuar në vijimësi thirrjet për kandidim, listat e kandidatëve, rezultatet e verifikimit |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | dhe rezultatet përfundimtare të vlerësimit. |
| 4. Mbështetja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet hartimit të raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. | KLD/KLGJ/ KLP | 1/4 e subjekteve (Mbledhja e statistikave, kryerja e shortit, mbledhja e informacionit të nevojshëm, analiza e informacionit, hartimi i relacionit dhe inventarizimi i praktikës.) | 232 000 | | | | E realizuar | **KLGJ**<br>KLGJ, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për periudhën Janar – Shtator 2020 kanë organizuar 111 shorte për përzgjedhjen e dosjeve për 111 subjekte të rivlerësimit kalimtar. Janë depozituar pranë KPK-së dhe ONM-së 40 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara, të shoqëruara me 200 dosje gjyqësore për 40 subjekte rivlerësimi si dhe janë në proces dorëzimi (të përfunduar) 12 raporte të tjera.<br>Gjithsej, duke marrë parasysh edhe punën e realizuar që nga momenti i krijimit të organeve të pavaruara të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, deri më 30 shtator 2020 janë dorëzuar pranë KPK dhe ONM 250 raporte vlerësimi.<br><br>**KLP**<br>Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në KLP, në mbështetje të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për periudhën e raportimit, janë kryer 41 Raporte për analizimin e aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit (prokuror). |
| 5. Ngritja dhe vënia në funksion e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me qëllim të rishikimit të CV-ve të anëtarëve të institucioneve të drejtësisë. | KED | | | 13 000 | O (zero )<br><br>Nuk është miratuar akoma asnjë fond për vitin 2020 | O (zero ) lekë | E Realizuar | **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**<br>Gjatë periudhës janar – shtator 2020, KED ka zhvilluar 5 mbledhje.<br><br>***Mbledhja e parë*** u zhvillua në datë **<u>15.01.2020</u>** me rend dite si më poshtë:<br><br>5. Kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me përbërjen e zgjedhur për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për vitin kalendarik 2020.<br><br>6. Çështje të mbështetjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me mjete buxhetore, personel administrativ, ambiente dhe pajisje pune nga Gjykata e |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Lartë për vitin 2020.<br><br>7. Informacion për vendet vakante ekzistuese për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të cilat sipas Kushtetutës plotësohen nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë.<br><br>8. Procedura e shortit për caktimin e anëtarëve relatorë për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendet vakante si më poshtë:<br><br>○ Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo. Pas hedhjes së shortit, u caktua relatore znj.Saida Dollani dhe aktualisht për këtë pozicion vijon procedura për verifikimin e kushteve ligjore.<br><br>○ Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj. Pas hedhjes së shortit, u caktua relatore znj.Arta Marku dhe aktualisht për këtë pozicion vijon procedura për verifikimin e kushteve ligjore.<br><br>○ Vendi vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi. Pas hedhjes së shortit, u caktua relatore znj. Miranda Andoni dhe aktualisht për këtë pozicion vijon procedura për verifikimin e kushteve ligjore.<br>Gjithashtu, pas organizimit të shortit për caktimin e këshilltarëve ligjorë të ngarkuar me mbështjetjen e veprimeve të relatorëve për dy nga vendet vakante, rezultatet janë si më poshtë:<br>○ Caktimi i z. B.Rrapaj, Këshilltar për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda Andoni lidhur me procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Altin Binaj, Artan Spahiu dhe Gentian Mete, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.<br><br>○ Caktimi i z.**Florjan Kalaja, Këshilltar për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Eugen Papandile, Sonila Bejtja dhe Zhaklina Peto, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.<br><br>○ Caktimi i znj. Laureta Nezaj, Këshilltare për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Arta Marku për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës së kandidatit Besnik Muçi, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës, për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj, si dhe për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Dedë Kasneci dhe Sergjio Mazreku, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.<br><br>○ Caktimi i z. Saimir Nazifi, Këshilltar për ndjekjen e veprimeve në mbështetje të relatores Miranda Andoni për procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave të kandidatëve Sinan Tafaj dhe Shaqir Hasanaj, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, në |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 22.11.2019 nga Presidenti i Republikës për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.<br>***Mbledhja e dytë e KED*** u zhvillua më datë **<u>03.02.2020</u>**, gjatë së cilës u diskutuan çështje e mëposhtme:<br><br>6. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”;<br><br>7. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”;<br><br>8. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;<br><br>9. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;<br><br>10. Ngritjen e një grupi pune për hartimin e |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.<br>***Mbledhja e tretë e KED*** u zhvillua më date 05.02.2020, gjatë së cilës u vijua me diskutimin e cështjeve të mbledhjes së datës 03.02.2020 dhe në përfundim u miratuan:<br><br>3. Projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 08.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi";<br><br>4. Projektvendimi "Për një shtesë në vendimin nr.2, datë 15.02.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion".<br>***Mbledhja e katërt e KED*** u zhvillua më date 06.02.2020, gjatë së cilës u vijua me diskutimin e cështjeve të mbledhjes së datës 03.02.2020 dhe në përfundim u miratuan:<br><br>3. Projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë";<br><br>4. Projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.<br>Gjithashtu, Këshilli ngarkoi Kryetarin që, brenda afatit një mujor, me mbështetjen e këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, të përgatisin dokumentin e projektrregullores së brendshme me objekt detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, kryerjen e veprimeve të ndryshme administrative, krijimin, qarkullimin, ruajtjen dhe mbajtjen e dokumentacionit dhe të regjistrave, të protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve.<br>***Mbledhja e pestë e KED*** u zhvillua më date 30.06.2020, gjatë së cilës u diskutuan cështjet e mëposhtme:<br><br>3. Diskutime dhe vlerësime në lidhje me rekomandimet e bëra nga Komisioni i Venecias në Opinionin nr.978/2020, datë 19 qershor 2020 “Për Emërimin e Gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese” përsa i takon veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.<br>Sa i takon pikës së parë të rendit të ditës, KED vendosi të ngrihet një grup pune i përbërë nga anëtarja e KED Znj. Saida Dollani dhe anëtarja zëvendësuese Znj. Marsida Xhaferllari, të cilat do të punojnë intensivisht mbi pasqyrimin e rekomandimeve të bëra nga Komisioni i Venecias në Opinionin nr.978/2020, datë 19 qershor 2020 “Për Emërimin e Gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese” përsa i takon veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Këto rekomandime do të pasqyrohen në aktet rregullatore të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për të bërë të mundur vijimin e procesit në tërësi mbi përzgjedhjen e kandidaturave për vendet vakante<br>Të tjera që lidhen me vijimësinë e përgatitjes së çështjeve të shortuara. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | 4. Në lidhje me vijimësinë e përgatitjes së çështjeve të shortuara u bë me dije nga anëtarët relatorë se dy nga vakancat e përkohëshme që i takojnë institucionit të Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë, janë përgatitur plotësisht dhe në një kohë sa më të afërt do t'u përcillen kandidaturave përkatëse. Lidhur me vakancën e tretë që i takon Presidentit të Republikës, nuk është përfunduar ende i gjithë procesi standard i verifikimit.<br><br>Në vijim KED raporton se:<br>Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vijuar procesin e verifikimit të kandidatëve për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e kushteve formale të parashikuara nga ligji. Konkretisht:<br>1- Për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datë 21.08.2019, u ndaluan të gjithë kandidatët, si dhe u tërhoqën, gjithashtu është njoftuar organi i emërtesës për rishpalljen e këtij vendi vakant.<br>2- Për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datë 27.09.2019, u ndaluan të gjithë kandidatët, si dhe u tërhoqën, gjithashtu është njoftuar organi i emërtesës për rishpalljen e këtij vendi vakant.<br>3- Për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, rezulton:<br>- Janë ndaluar 6 kandidat<br>- 1 kandidat është tërhequr dhe është mbyll procedura e verifikimit.<br>- 1 kandidat është lejuar.<br>- 2 kandidat janë në proces verifkimi dhe do të merren në shqyrtim ditën e premte datë 09.10.2020. |
| ***Nën-objektivi 1/b: Përmirësimi i eficencës së sistemit të drejtësisë*** | | | | | | | | |
| **Masat / Aktivitetet e parashikuara** | **Institucioni Përgjegjës** | **Targeti / Milestones 2020** | **Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 – 2021** | | **Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)** | | **Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020** | **Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020** |

| | | | PBA | Donatorë | PBA | Donatorë | *(E realizuar / në proces / e parealizuar)* | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.Funksionimi i plotë i KLGJ-së e KLP-së me kuadrin rregullator, kapacitetet dhe infrastukturën e nevojshme për të përmbushur funksionin. | KLGJ<br>KLP | Zbatimi në masën 70% i përmirësimeve të nevojshme në infrastrukturë.<br><br>Monitorim dhe zbatim i planit të veprimit për normën e likujdimit dhe kohëzgjatjen e çështjeve në 4 gjykata. | 30 000 | 1 470 000 | 75 205 (në mijë lekë | | Realizuar | **KLGJ**<br>KLGJ, me Vendimin nr.13, datë 18.01.2019, vendosi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme të këtij Këshilli, dhe konkretisht të:<br>- Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,<br>- Komisioni Disiplinor,<br>- Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,<br>- Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.<br><br>Funksionimi i këtyre komisioneve, realizimi i detyrave dhe përgjegjësive të tyre për fushën e veprimtarisë që mbulojnë ndikon në përmbushjen më së miri të detyrave të Këshillit në përgjithësi. Ngritja e komisioneve të përhershme nga ana KLGJ-së nuk është vetëm një përmbushje e detyrimit ligjor por funksionimi i tyre ndihmon thelbësisht në përmbushjen me efikasitet të përgjegjësive dhe detyrave që ligji i ngarkon KLGJ-së. Atashimi pranë këtyre komisioneve edhe i një njësie prej 10 këshilltarësh, parashikuar kjo në strukturën administrative të KLGJ, është në dobi të efikasitetit dhe eficencës së Këshillit për t'iu pëgjigjur në kohë dhe me cilësi nevojave me të cilat përballet pushteti gjyqësor.<br><br>Përsa i pëket strukturës organizative, KLGJ-ja ka miratuar me Vendimin nr. 12 datë 18.01.2019, i ndryshuar (Vendimi nr. 44 datë 12.03.2019, i ndryshuar me Vendim nr. 80, datë 30.05.2019) një administratë me të gjithë njësitë e duhura mbështetëse.<br><br>Në total nga momenti i miratimit të strukturës deri në 30 shtator 2020, struktura është plotësuar në masën 82.4% (103 punonjës nga 125 të miratuar). Kjo ka mundësuar rritjen e efikasitetit në çdo njësi, duke rritur edhe cilësinë e përpunimit të akteve, shkresave, si dhe përmirësim e ndjeshëm të afateve kohore të realizimit të këtyre detyrave.<br><br>Megjithatë, nevoja për burime njerëzore nuk është |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | adresuar plotësisht, për shkak se infrastruktuara ekzistuese e ish-godinës së KLGJ nuk krijonte mundësinë e funksionimit me një strukturë të plotë. Procesi i rekrutimeve për të përmbushur strukturën e miratuar të KLGJ-së me 125 punonjës dhe për pasojë funksionimin e saj me kapacitet të plotë, po vijon më intensivisht që nga momenti i transferimit tek mjediset e Polit të Drejtësisë (gusht 2020), ku janë siguruar hapësirat e nevojshme të punës.<br><br>Analiza mbi normën e likuidimit të çështjeve është bërë në shkallë vendi në kuadrin e raportit vjetor të KLGJ-së. Për sa i përket veprimeve konkrete për rritjen e normës të likuidimit të çështjeve, KLGJ ka ndërmarrë një numër masash në lidhje me delegimet e gjyqtarëve dhe transferimin e përkohshëm. Po në këtë drejtim shërben edhe Vendimi Nr.78 datë 30.05.2019 "për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit".<br><br>**KLP**<br>Që prej muajit Qershor 2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë po e kryen aktivitetin e tij pranë Godinës "Poli i Drejtësisë", duke plotësuar kushtet dhe infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur funksionin.<br><br>Organigrama e miratuar nga Këshilli i Ministrave ka një numër prej 65 punonjësish.<br><br>Për periudhën Janar- Shtator 2020 ka përfunduar procedura e rekrutimit të 12 nëpunësve civilë, si dhe janë kryer 3 rekrutime jashtë shërbimit civil.<br><br>Buxheti vjetor i alokuar ka shumën prej 152 324 (në mijë lekë), ndër të cilat 17 000 (në mijë lekë) janë parashikuar për investime. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| 2. Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe të policisë gjyqësore dhe shpërndarjen e gjykatave në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura gjyqësore me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave dhe për të siguruar qasje në drejtësi. | KLGJ | Zbatimi i hartës gjyqësore. | | 762 500 | | | Në Proces | KLGJ është në proces të përcaktimit të juridiksionit territorial dhe përmasave të gjykatave. Grupi i ndërinstitucional i punës, (i përbërë nga përfaqësues nga gjykatat e vendit, KLGJ, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë si: Këshilli i Evropës, EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të Gjithë” - USAID), bazuar në metodologji dhe standarde ndërkombëtare, pas një analize paraprake, ka përfunduar draftin e hartës së re gjyqësore. Ky draft i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë më datë 29 shtator 2020.<br><br>Në vijim, dhe pas konsultimeve me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe aktorë të tjerë, draft propozimi do t’i përcillet Këshillit të Ministrave në formën e një projektvendimi. Nisma është planifikuar në katërmujorin e tretë të viti 2020.<br><br>**Ministria e Drejtësisë**<br>Nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, është propozuar përcjellja për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimi “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave". Kjo nismë do të propozohet në |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | kuadër të punës së përbashkët me KLGJ. Nisma është planifikuar në katërmujorin e tretë të viti 2020. |
| 3. Ngritja e një plani pune për reduktimin e numrit të çështjeve të mbartura. | KLGJ/GJL | Zbatimi i Planit të Veprimit. | 2332 | | | | Realizuar | **KLGJ**<br>Në lidhje me reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, Këshilli me vendimin Nr.317 datë 19.12.2019, ka miratuar ngritjen e një komisioni të përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë. Përballë numrit të jashtëzakonshëm dhe kohës së gjatë të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar dhe në respektim edhe të kritereve ligjore për gjykimin e tyre, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve vlerësoi se do të vijohet menjëherë me shqyrtimin e rekurseve të çështjeve të themelit, nisur nga kriteri i kohës së paraqitjes së tyre për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, krahas çështjeve të tjera që për nga natyra e tyre dhe sipas ligjit duhet të shqyrtohen në mënyrë të shpejtë, sikurse janë mosmarrëveshjet për juridiksionin, kompetencën, kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve.<br><br>Një masë tjetër e marrë nga Këshilli për ri-funksionimin e Gjykatës së Lartë është miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes KLGJ dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).<br><br>Mbështetja e administrimit të Gjykatës së Lartë me burime njerëzore për të ulur numrin e çështjeve të |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | prapambetura është ndër kontributet më të rëndësishme që Memorandumi ofron. Për më tepër, memorandumi parashikon përmirësimin dhe modernizimin e proceseve të punës në këtë gjykatë, si dhe zbatimin e TIK-ut në funksion të transparencës dhe marrëdhënieve me publikun.<br><br>Aktualisht, 12 operatorë janë angazhuar në uljen e numrit të çështjeve të pazgjidhura dhe po punojnë për të krijuar një inventar të detajuar të pothuajse 35,000 çështjeve të mbetura në këtë gjykatë. Ky inventar do të shërbejë si bazë për kategorizimin e çështjeve në grupe, të cilat më pas do të adresohen nga këshilltarët ligjorë dhe gjyqtarët. Vlen të përmendet gjithashtu se kohët e fundit, Këshilli, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, ka zhvilluar një Udhëzues për Efikasitetin e Gjykatës së Lartë dhe Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura. Ky dokument, i cili parashikon një sërë masash konkrete, të përqendruara kryesisht në ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të kualifikuar dhe emërimin e më shumë këshilltarëve ligjorë, synon të adresojë situatën e krijuar në këtë gjykatë për shkak të numrit të lartë të çështjeve në pritje.<br><br>**Gjykata e Lartë**<br>Në zbatim të dispozitave ligjore për organizimin e Gjykatës së Lartë, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, duke qenë një nga strukturat drejtuese brenda gjykatës, u mblodh për të diskutuar organizimin e Kolegjeve të Gjykatës. Pas vlerësimit të mendimit të shprehur nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Këshilli i Gjykatës vendosi për emërimin e gjyqtarëve në përbërjen e Kolegjeve të Gjykatës dhe emërimin e gjyqtarëve në përbërjen e trupave gjykues (Vendimet nr. 1 dhe nr.2, datë 09.04.2020 të Këshillit të Gjykatës). Që nga momenti i emërimit e deri më tani, Kolegjet e Gjykatës së Lartë kanë vazhduar rregullisht me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, sipas kompetencave përkatëse. Bazuar në të dhënat statistikore të përpunuara nga administrata e Gjykatës së Lartë, për periudhën Prill - 9 Korrik 2020, Kolegjet e Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar në total **866** çështje, nga të cilat: **400** çështje ***administrative***; **216** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | çështje ***penale*** dhe **250** çështje ***civile*** (ku përfshihen: shqyrtimi gjyqësor i themelit të çështjes, përcaktimi i juridiksionit dhe kompetencës, masa sigurie, kërkesa për pezullim / revokim të vendimit të gjykatave më të ulëta etj). |
| ***Nën-objektivi 1/c: Përmirësimi i llogaridhëniens së institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane*** | | | | | | | | |
| **Masat / Aktivitetet e parashikuara** | **Institucioni Përgjegjës** | **Targeti / Milestones 2020** | **Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021** | | **Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)** | | **Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020 *(E realizuar / në proces / e parealizuar)*** | **Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020** |
| | | | **PBA** | **Donatorë** | **PBA** | **Donatorë** | | |
| 1. Krijimi i Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, të ngarkuar me përgjegjësinë për të verifikuar ankesat, hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjithë niveleve, anëtarëve të KLGJ e KLP, Prokurorit të Përgjithshëm dhe për të zhvilluar shërbime të tjera të inspektimit në gjykata dhe prokurori në pajtim me standardet evropiane. | Kuvendi i RSH<br>ILD | 75 perqind e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorë ve të procesohe n sipas afatit ligjor | 74 211 | | 7 346 | | Në Proces | **Ministria e Drejtësisë**<br>Në lidhje me procedurat e brendshme të funksionimit, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është përgatitur projektvendimi 'Për krijimin e kushteve për inspektorin e Lartë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore, verifikimin e figures dhe pasurisë së kandidatëve jomagjistratë', i cili është miratuar me vendimin nr. nr.536, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 110, datë 29.07.2019.<br>Shënim: e realizuar për sa i takon MD-së, konkretisht hartimi i akti nënligjor refeuar si më sipër.<br><br>**KUVENDI i RSH**<br>Kuvendi ka permbushur funksion kushtetues atë të zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka miratuar strukturën e këtij organi.<br><br>**ILD**<br>Lidhur me këtë aktivitet të parashikuar, për institucionin e ILD-së, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë në dorëzim ankesa të depozituara nga çdo person fizik ose juridik lidhur me pretendimin për shkeljet e kryera nga ana e magjistratëve, konkretisht për periudhën Shkurt-Qershor (pasi ky institucion është themeluar më datë 1 Shkurt 2020), janë depozituar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Drejtësisë rreth 410 ankesa nga qytetarët; rreth 757 ankesa të marra nga KLGJ si ankesa të prapambetura; 107 ankesa të depozituara nga institucione të tjera; Sa i përket konfirmimeve të dërguara drejt qytetarëve për marrjen e ankesave pranë Zyrës së ILD-së për periudhën Shkurt- Qershor 2020, janë dërguar rreth 403 konfirmime mbi ankesat e depozituara nga qytetarët; si dhe 600 konfirmime mbi ankesat e prapambetura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Lidhur me verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar, përgjatë periudhës Janar-Qershor 2020, rezulton të jenë miratuar rreth 16 vendime mbi verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar; rreth 27 vendime mbi arkivimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar; rreth 20 kërkesa drejtuar gjykatave apo prokurorive, mbi informacione ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve të kërkuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kuadër të verifikimit të ankesave; rreth 27 njoftime mbi vendimet e arkivimit të ankesave; rreth 5 vendime arkivimi pas verifikimit të ankesës; si dhe bazuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenet 194/3 dhe 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 5 vendime për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë. Vlen të theksohet se momentalisht janë në trajtim për shqyrtim fillestar rreth 40 ankesa;<br>Gjithashtu, në funksion të kryerjeve të inspektimeve pranë gjykatave dhe prokurorive, "Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt "Lirimin me Kusht"; dhe 1 vendim "Për shtimin e objektit të inspektimit tematik të caktuar me vendimin nr. 1 datë 11.02.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"; |
| 2. Hartimi dhe publikimi i standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes për magjistratët si dhe monitorimi i zbatimit të tyre. | KLGJ/ KLP | Monitorim i zbatimit të standardeve. Zbatimi i procedura ve. | 17 250 | 17 250 | | | Në Proces | **KLGJ**<br><br>Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ përgjegjës për miratimin e rregullave dhe kodit të etikës dhe për monitorimin e tyre, dhe specifikisht Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | po konsideron me prioritet përgatitjen e draftit të parë të standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, sipas Ligjit nr. 115/2016.<br><br>Me vendimin nr. 208, datë 11.10.2019, KLGJ caktoi një gjyqtar si këshilltar për etikën<br><br>**KLP**<br><br>Nuk ka ende zhvillime për periudhën e raportimit. |
| 3. Hartimi i bazës nënligjore mbi procedurat dhe kriteret e shqyrtimit dhe vlerësimit të masave të propozuara disiplinore ndaj gjyqtarëve e prokurorëve. | KLGJ<br>KLP | Zbatimi i procedurave | | 7 500 | | | Në Proces | **KLGJ**<br>KLGJ, në përputhje me objektivin nr. 3 të Planit Strategjik të KLGJ "Sigurimi i mirëfunksionimit të gjykatave, përmes miratimit të rregullave të unifikuara të administrimit të gjykatave", miratoi me vendimin Nr. 316, datë 14/09/2020 rregulloren për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor.<br><br>Ky akt normativ përcakton elementet kryesore proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore.<br><br>Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me procedura disiplinore të zhvilluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj gjyqtarëve të të gjithë niveleve.<br><br>Kjo rregullore përcakton:<br>a) kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetarit, relatorit dhe anëtarëve, si dhe detyrat e këshilltarit ligjor përgjegjës të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve dhe të personelit administrativ të Këshillit;<br>b) marrëdhëniet e Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare, me këshilltarin ligjor përgjegjës të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve, personelin administrativ të Këshillit, ankuesin, gjyqtarin dhe Inspektorin e Lartë i Drejtësisë;<br>c) rregulla për ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e dokumentacionit që lidhet me procedurat disiplinore;<br>ç) rregulla për krijimin, trajtimin, qarkullimin, shfrytëzimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit që bëhet pjesë e dosjes së procedurës disiplinore, si dhe sigurimin e aksesit të subjekteve pjesëmarrëse në këtë dokumentacion.<br><br>**KLP**<br>Është në proces hartimi i Rregullores "Për përcaktimin e procedurave të zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj magjistratëve prokurorë ". |
| 4. Përmirësimi i transparencës së procesit të vlerësimit të masave disiplinore. | KLGJ | Anonimizimi dhe publikimi në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve. | 8 000 | 3 750 | | | Realizuar | KLGJ, me vendimin Nr. 316, datë 14/09/2020 mbi rregulloren për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor, përcakton edhe aspektet e njoftimit të akteve:<br>1. Aktet e procedurës sipas kësaj rregulloreje i njoftohen palëve në një ose disa nga format e mëposhtme:<br>a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;<br>b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;<br>c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.<br>2. Vendimi i Këshillit bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.<br>Gjithashtu, kjo rregullore, në nenin 34 vlerëson publicitetin e seancës dhe më tej në nenin nenin 43 publikimin e vendimeve disiplinore:<br>1. Këshilli publikon, brenda 2 javëve, çdo vendim të formës së prerë për shkarkimin e magjistratëve në faqen zyrtare.<br>2. Këshilli publikon ekstrakte të çdo vendimi përfundimtar për çështje disiplinore, duke përcaktuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre, si dhe llojin e shkeljes disiplinore të kryer sipas këtyre fakteve. Botimi i ekstrakteve duhet të mbrojë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast në ekstrakt nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e magjistratit. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. Reduktimi i vonesave në vlerësimin vjetor periodik të magjistratëve. | KLGJ | 4 vjet vonesë (backlog) KLGJ ka vlerësuar të paktën 90% të gjyqtarëve sipas planit vjetor tëVLERESIMIT | 57 150 | | | | Në Proces | Një tjetër element i rëndësishëm për karrierën e gjyqtarëve është edhe plotësimi i kuadrit nënligjor për krijimin e skemës së vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve. Në këtë kuadër janë hartuar edhe aktet nënligjore për realizimin e këtij procesi me synim (i) përmirësimin e vazhdueshëm të aspektit etik dhe profesional të gjyqtarëve; (ii) vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve; (iii) zhvillimin e karrierës së gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale, si dhe (iv) identifikimin e nevojave për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues.<br><br>• vendimi nr. 263, datë 21.11.2019 “për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”<br>• vendimi nr. 264, datë 21.11.2019 “për miratimin e metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”<br>• vendimi nr. 316, datë 19.12.2019 “për miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”<br>• vendimi nr. 120, datë 05.03.2020 “për miratimin e formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit”<br>• vendimi nr. 197, datë 11.06.2020 “për miratimin e rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”<br><br>Programi i Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve për vitin 2020 është miratuar nga KLGJ dhe parashikon vlerësimi e 121 gjyqtarëve përgjatë vitit 2020.<br><br>Këshilli, me vendimin nr. 198, datë 11.06.2020 (18 gjyqtarë) dhe me vendimin nr. 233, datë 02.07.2020 (3 gjyqtarë), filloi procedurën e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe caktoi relatorin dhe nëpunësin përgjegjës për vlerësimin për |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | secilin gjyqtar. Aktualisht ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për gradimin e 21 (njëzetenjë) gjyqtarëve;<br><br>Po kështu, KLGJ, me vendimet nr. 247 datë 09.07.2020 dhe nr. 314, datë 14.09.2020, "Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019", ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 24 (njëzetekatër) gjyqtarë, vlerësim i cili do të bazohet në veprimtarinë gjyqësore të vitit të fundit. |
| ***Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit dhe formimit ligjor si edhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave***<br>***Nën-objektivi 2/a: Kualifikimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit të gjykatës sipas standardeve/kërkesave evropiane*** | | | | | | | | |
| **Masat / Aktivitetet e parashikuara** | **Institucioni Përgjegjës** | **Targeti / Milestones 2020** | **Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021** | | **Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)** | | **Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020 *(E realizuar / në proces / e parealizuar)*** | **Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020** |
| | | | **PBA** | **Donatorë** | **PBA** | **Donatorë** | | |
| 1.Thellimi dhe zgjerimi i aktivitetit të Shkollës së Magjistraturës në drejtim të rekrutimit dhe ofrimit të programeve trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe kategoritë e tjera të personelit të gjykatave dhe prokurorive nëpërmjet përmirësimit të programit të rekrutimit dhe kurrikulave për kandidatët për magjistratë, si dhe krijimi i kurrikulave të reja dhe moduleve të trajnimit për kategoritë e tjera. | SHM | Përmirësi m kurrikula për vitin e dytë të formimit fillestar përkandidatët magjistrat ë/ndihmës ligjorë. Zhvillohen 3 kurrikula të reja dhe të paktën një kurs online për trajnimin e vazhduesh ëm | | 2 681<br><br>2011 ('19);<br><br>670 ('20) | | | Në Proces | **Shkolla e Magjistraturës**<br>Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Qendrën Hollandeze të Studimeve dhe Trajnimit Gjyqësor (SSR) dhe Misionin Euralius V, pas miratimit të kurrikulës mësimore të vitit të parë të Programit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë, këshilltarë ë ndihmës ligjorë, ka filluar procesin e përmirësimit të kurrikulës mësimore të vitit të dytë të Progrsmit të Formimit Fillestar për kandidatët për magjistratë. Ky proces drejtohet nga Drejtori, Këshilli Pedagogjik dhe pedagogët përgjegjës të lëndëve të vitit të dytë të Programit të Formimit Fillestar dhe pritet të përfundojë në fund të muajit Shtator 2020, kur dhe mund të miratohen këto kurrikula nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës. |
| 2. Transformimi gradual i Shkollës së Magjistraturës në një qendër burimore dhe pikë takimi për të drejtën e Bashkimit Evropian dhe të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ofrimi i kushteve optimale të trajnimit për magjistratët | KLGJ, SHM | Përfundim i i fazës së parë të punimeve. Raport vjetor progresi. | 798 345<br><br>306 345 ('19)<br><br>246 000 ('20)<br><br>246 000 | | | | Në Proces | **KLGJ**<br>Mendojmë të rishikohet roli i KLGJ si institucion përgjegjës, pasi në bazë të ligjit nr. 115/2016 "për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" Shkolla e Magjistraturës gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara në ligj: KLGJ nuk ka rol as në përfundimin e fazës së parë të punimeve dhe as në përgatitjen e raportit vjetor të progresit. (dy |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| dhe personelit të gjykatave.Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore për Shkollën e Magjistraturës. | | | ('20) | | | | | objektivat për vitin 2020).<br><br>Për sa i përket bashkëpunimit mes KLGJ dhe SHM, vlen të theksohet që KLGJ ka dhënë opinion në mbledhjen plenare të datës 2 korrik 2019 për draft programin tematik 2019-2020 të ShM si dhe kurrikulat e trajnimit 8 javor për kancelarët e gjykatave. Gjithashtu, një pjesë e anëtarëve të KLGJ kontribuojnë edhe në rolin e lektorëve të ftuar në trajnimin fillestar në ShM, si edhe të ekspertëve në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve. Këshilli, në lidhje me komandimin e gjyqtarëve si pedagogë të brendshëm, ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës dhe ka treguar kujdesin maksimal për të siguruar transparencë të plotë në vendimmarrje dhe rritje të kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës.<br><br>**SHM**<br>Shkolla e Magjistraturës duke filluar nga muaji Tetor 2019 është zhvendosur, përkohësisht në ambjente të reja, të cilat plotësojnë pjesërisht kërkesat për zhvillimin normal të programit të formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe kandidatëve për këshilltar e ndihmës ligjorë, kancelarëve, avokatëve të shtetit, gjithashtu dhe të nevojave të programit për trajnim të vazhduar të magjistratëve në detyrë. Në këto ambjente i jepet zgjidhje e përkohëshme edhe nevojave për hapësira më të përshtatshme pune për stafin akademik dhe administrativ të Shkollës. Me VKM nr.234, dt. 17.04.2019, Shkolla e Magjistraturës do të ushtrojë veprimtarinë e saj në të njëjtën godinë me KLGJ dhe KLP. Për periudhën Janar-Shtator 2019 nuk ka asnjë kosto nga ana e Shkollës.<br>Në vijim të procedurave për ndërtimin e godinës së re të Shkollës së Magjistraturës, në respektim të afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur me studion projektuese, në dhjetor të vitit 2019 eshte dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), Projekti i Zbatimit për ndërtimin e saj. Vlera e parashikuar e ndërtimit dhe e mobilimit është rreth 529.923.000 lekë. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. Rritja dhe përmirësimi i punës kërkimore shkencore nëpërmjet pasurimit të fondit të bibliotekës dhe sigurimi i aksesit në bibliotekat digjitale. | SHM | 100 libra literature vendase dhe të huaj, botime shkencore | 6 048;<br><br>2 170 ('19);<br><br>1 939 ('20);<br><br>1 939 ('21) | | | | Në Proces | **SHM**<br>Shkolla e Magjistraturës, për periudhën Janar – Shtator 2020, ka botuar 1 numër të Revistës "Jeta juridike", konkretisht nr. 3 të vitit 2019, në 300 kopje. Deri më tani është investuar në pasurimin e biblotekës së Shkollës. Konkretisht, fondi i bibliotekës së Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Janar-Qershor 2020, është rritur me 40 njësi bibliotekare. Të gjitha këto njësi janë dhuruar nga partnerë të Shkollës. |
| 4. Trajnime dhe kualifikime për ngritjen e kapaciteteve këshilluese të vendimmarrjes dhe të stafit nëpunës civil në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të GJK, të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi. | GJK | Seanca trajnimesh për aspektet e reja te juridiksionit | 23 700 | | | | Në Proces | **Gjykata Kushtetuese**<br>Ka vijuar procesi i trajinimeve dhe kualifikime për ngritjen e kapaciteteve këshilluese të vendimmarrjes dhe të stafit nëpunës civil në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të GJK, të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi.<br>Fondi i parashikuar për këtë masë është 1.000.000 lekë.<br>Është realizuar një trajnim në muajin shkurt dhe janë shpenzuar 518.400 lekë. Masë e realizuar.<br>Nuk parashikohet të realizohen trajnime të tjera për shkak se pjesa tjetër është zbritur në kuadër të shkurtimit të fondeve në zbatim të Aktit Normativ nr. 28,datë 02.07.2020, Udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e Buxhetit 2020, detajimin e ndryshimeve të planit të buxhetit për shpenzimet korrente, për Gjykatën Kushtetuese.<br><br>• Në bashkëpunim me OSCE-në po realizojmë Planin Strategjik të Gjykatës Kushtetuese.<br>• Është realizuar një aktivitet me fondet e OSCE-së dhe Konrad Adenauer Stiftung në muajin korrik. Edhe kjo masë e realizuar.<br>• Për 6 mujorin e dytë parashikojmë realizimin e aktiviteteve të tjera në lidhje me Planin Strategjik me fondet e donatorëve.<br>Hartimi i rregullores së re së punës të Gjykatës Kushtetuese e cila do ti përshtatet ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. |
| ***Objektivi 3: Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen në gjykatë në përputhje me standardet evropiane***<br>***Nën - objektivi 3/a: Përmirësimi i transparencës në funksionimin e sistemit gjyqësor (Shënim: masat në lidhje me efikasitetin janë përfshirë nën Objektivin 1b)*** | | | | | | | | |

| Masat / Aktivitetet e parashikuara | Institucioni Përgjegjës | Targeti / Milestones 2020 | Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021 | | Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik) | | Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020 *(E realizuar / në proces / e parealizuar)* | Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | PBA | Donatorë | PBA | Donatorë | | |
| 1.Rritja e marrëdhënieve të gjykatave me median dhe sigurimi i qasjes së publikut në informacione për rastet me interes publik. | KLGJ | Trajnimi i këtij grupi target. Sigurimi i mjeteve logjistike | 500 | 4 000 | | | Realizuar | **KLGJ**<br>KLGJ, me vendimin nr. 68 datë 24.04.2019, ka përcaktuar anëtarin për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun. Gjithashtu, KLGJ, me urdhrin nr. 19 datë 09.04.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm, ka miratuar "Programin e Transparencës për Këshillin e Lartë Gjyqësor.<br><br>Me vendimin Nr. 126, datë 19.07.2019, KLGJ miratoi Planin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë për vitet 2019-2020, ku Objektivi nr. 5 i tij është përmirësimi i marrëdhënieve midis gjyqësorit, partnerëve dhe publikut, përmes hartimit dhe zbatimit të një strategjie të qartë komunikimi.<br><br>Aktualisht, KLGJ, në bashkëpunim me partnerët e Projektit "Drejtësi për të gjithë" (USAID), ka përfunduar hartimin e Projketplanit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor , nëpërmjet të cilit synohet përcaktimi i bazave për përmirësimin marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve.<br><br>Po ashtu, KLGJ ka përfunduar hartimin e projektrregullores "Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median", nëpërmjet të cilës synohet përcaktimi i parimeve, rregullave dhe procedurave të veçanta për komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj.<br><br>KLGJ, me vendimin Nr.280 datë 10.12.2019, ka caktuar 8 gjyqtarët për mediat, në çdo juridiksion apeli. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Në datën 22 janar 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi së bashku me Projektin “Drejtësi për të gjithë” (USAID), një aktivitet me gjyqtarët për mediat, nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun, si edhe me disa gazetarë që mbulojnë çështjet e drejtësisë.<br><br>Me ndihmën e projektit u mundësua edhe vënia në funksionim e faqes së re të internetit http://klgj.al/ ku pasqyrohet në mënyrë transparente e gjithë veprimtaria e KLGJ. |
| 2.Publikimi elektronik në kohë i vendimeve të gjykatave si dhe analizave vjetore të gjykatave / raporte efiçence dhe përditësimi i rregullt i faqes gjykata.gov.al. | KLGJ | Zbatimi në masën 100% | 18 000 | | | | Në Proces | **KLGJ**<br>Nga ana e gjykatave kryhet publikimi i të gjitha vendimeve, por Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve ICMIS nuk mundëson procesin automatik të fshirjes së të dhënave personale në tekstin e vendimeve gjyqësore. Aktualisht anonimizimi i të dhënave kryhet manualisht, dhe për rrjedhojë konsumon shumë kohë fizike dhe kërkon burime njerëzore shtesë.<br><br>Faqja ëëë.gjykata.gov.al është në fazën e prokurimit.<br><br>KLGJ, në bashkëpunim me Projektin “Justice for All”, është duke punuar për krijimin e një portali elektronik të unfikuar të sistemit gjyqësor ku KLGJ dhe të gjitha gjykatat do të kenë faqen e tyre të dedikuar. Ky portal do të mundësojë një transparencë më të mirë të veprimtarisë gjyqësore të gjykatave. |
| ***Nën-objektivi 3/b: Përmirësimi i aksesit në sistemin e drejtësisë*** | | | | | | | | |
| **Masat / Aktivitetet e parashikuara** | **Institucioni Përgjegjës** | **Targeti / Milestones 2020** | **Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021** | | **Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)** | | **Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020** ***(E realizuar / në proces / e parealizuar)*** | **Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020** |
| | | | **PBA** | **Donatorë** | **PBA** | **Donatorë** | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) është krijuar dhe ka funksionalitet të plotë. | MD | Krijimi i regjistrit elektronik funksional për menaxhim in e të dhënave për ndihmën juridike parësore dhe dytësore; Kalendar i mbajtur për fushatat ndërgjegjë suese; | 86 500 | | | | Në proces[6] | Funksionimi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me kapacitet të plotë:<br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër Nr. 59, datë 25.03.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndihmës Juridike Falas" me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br>Bazuar në strukturën e miratuar nga Kryeministri, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, ka në përbërje të saj drejtoritë e mëposhtme:<br>- Drejtori i Përgjithshëm;<br>- Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore;<br>- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike;<br>- Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse.<br>Sa i përket ecurisë së rekrutimeve bëjmë me dije se: Me Urdhër nr. 201, datë 01.7.2020, të Ministrit të Drejtësisë është emëruar Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (TND).<br>Për tre drejtorët e drejtorive të ndihmës juridike, janë shpallur në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, vendet vakante të mbetura, referuar strukturës së DNJF dhe konkretisht:<br>- Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore (Shpallja me nr. 3086);<br>- Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike (Shpallja me nr. 3083);<br>- Drejtor i Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse (Shpallja me nr. 3082).<br><br>Afati i dërgimit të dokumentacionit për procedurën e "lëvizjes paralele" dhe "ngritjes në detyrë" për këto pozicione përfundon më datë 30.09.2020. Në varësi të aplikimeve dhe përmbushjes së kritereve, pritet që procedura e shpalljes së fituesve të përfundojë |

[6] Krijimi i regjistrit elektronik për menaxhimin e të dhënave të ndihmës juridike parësore dhe dytësore (CMS).

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | brenda muajit Tetor 2020, duke plotësuar kështu strukturën e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe bërjen të mundur të funksionimit me kapacitete të plota.<br>Ne muajin Gusht me aktin nr.2942 prot., datë 16.07.2020, DAP ka njoftuar emërimin e e Specialistit të Arkiv/Protokoll Sekretare nga lista e fituesve, ndër të tjera po në muajin gusht janë rinovuar kontatat me punonjësit e qendrës Tiranë. Ndërsa përgjatë muajit Shtator DNJF ka përfunduar procedurat e rekrutimit të punonjësve me trajnim të posaçëm për qendrën e Lushnjes (hapur më 8 shtator 2020), qendrën e Pogradecit dhe atë të Gjirokastrës (të cilat priten të inagurohen gjatë muajit tetor 2020).<br>Muaji Shtator shënon një arritje të rëndësishme sa i përket miratimit të akteve të fundit nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2017, duke plotësuar kështu të gjithë kuadrin ligjor në fushën e ndihmës juridike. Tashmë, ligji nr.111/2017 është plotësuar dhe ndiqet nga 13 akte nënligjore të cilat rregullojnë në mënyrë të detajuar çdo fushë specifike të ndihmës juridike dhe kanë sjellë një serë risish e procedurash të reja.<br>Procedura e hartimit dhe miratimit të akteve është një procedurë e cila është ndjekur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë sipas përcaktimeve të ligjit 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Pas një procesi të gjatë bashkëpunimi me aktorët përgjegjës në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti në muajin Shtator 2020 u bë i mundur miratimi i dy prej akteve nënligjore më të rëndësishme sa i përket mirëfunksionimit të sistemit të ndihmës juridike dytësore, konkretisht:<br>- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 5.8.2020 "Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore";<br>- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nr. 17 datë 05.08.2020 "Për rregullat e zbatimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative". |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Këto akte përcaktojnë rregulla të hollësishme për përgatitjen e listave dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore për qytetarët në proceset civile dhe administrative në zbatim të parimit të rotacionit, si dhe kriteret dhe tarifat e shpërblimit për këtë shërbim.<br>Në kuadër të hyrjes në fuqi të këtyre 2 akteve u zhvillua një aktivitet prezantues më datë 16.09.2020, me pjesëmarrjen e Zëvëndës Ministrit të Drejtësisë, përfaqësuesve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore; Dhomave Vendore të Avokatisë, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë si dhe ekspertëve të fushës.<br>Që nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së tyre, specialistët e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë angazhuar në hartimin e akteve të brendshme me karakter rregullues, konkretisht:<br>- Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;<br>- Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (shtojcë e Rregullores së Brendshme të Drejtorisë).<br>Kjo rregullore i është përcjellë për miratim Ministrit të Drejtësisë me shkresën me nr. 243/1 datë 20.08.2020.<br>Gjithashtu, DNJF ka propozuar që si pjesë e kësaj rregulloreje të përfshihet edhe kreu nr. VI "Organizimi dhe funksionimi i komisionit vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikantëve për financim të ojf të autorizuara dhe komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të ojf të autorizuara që përfitojnë financim nga buxheti i shtetit" si nje detyrim i përcaktuar në pikën 13 të VKM nr. 110 datë 06.03.2019," Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre" ku përcaktohet se: "Rregulla më të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit vlerësues dhe komisionit të ankimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që miratohet |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | me urdhër të ministrit të Drejtësisë”.<br>Miratimi i Rregullores së Brendshme të DNJF do të jetë një tjetër hap i rëndësishëm në funksion të mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit të këtij institucioni duke synuar parashikime të detajuara dhe rregulla specifike për çdo proces të parashikuar nga ligji. Shtojca që i bashkëlidhet kësaj rregullore synon standardizimin e rregullave dhe procedurave dedikuar qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, si ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore të shpërndara në qarqe të ndryshme të vendit.<br>Krijimi i regjistrit elektronik funksional për menaxhimin elektronik të të dhënave për ndihmën juridike parësore dhe dytësore:<br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është duke bashkëpunuar me EURALIUS dhe SOROS për krijimin dhe bërjen funksionale të CMS (Case Management System), që do të shërbejë për gjenerimin e të dhënave për ndihmën juridike parësore dhe dytësore.<br>Krijimi i këtij sistemi është në proces. Në funksion të tij, janë kryer disa takime me ekspertët e kontraktuarnga donatorët.<br>Funksionimi i sistemit si një bazë totale e të dhënave të shërbimeve të ndihmës juridike është në proces dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike është duke vlerësuar se cili sistem është më i përshtatshëm për të përmbushur objektivat që DNJF ka sa i përket administimit dhe kontrollit të tëdhënave.<br>Kalendari i fushatave ndërgjegjësuese:<br>Lidhur me ndërgjegjësimin , DNJF ka hartuar një kalendar aktivitetesh dhe ka vijuar me një sërë aktivitetesh si më poshtë (shih masat në vijim). |
| 2. Sistemi i Ndihmës Juridike Parësore ka funksionalitet të plotë. | DNJF | Mbulohen 90% e nevojave për ndihmë parësore në shkallë vendi 4 qendra të tjera të shërbimit të ndihmës juridike; Janë zhvilluar fushta ndërgjegjë suese Ngritja dhe funksioni mi i klinikave ligjore pranë universiteve private; Program të | 29 000 | | | | | **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas**<br><br>Në zbatim të kësaj mase janë ndërmarrë një sërë aktivitetesh të cilat kan<br><br>**Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore:**<br><br>Referuar planit të punës Korrik - Dhjetor 2020, Drejtoria e Ndihmës Jur<br><br>**Më datë 08 shtator 2020**, u zhvillua inagurimi i qendrës së shërbimit të |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | trajnimit vazhdues për ofruesit e ndihmës juridike (ASPA; donator); | | | | | Realizuar | *Aktualisht, qytetarët përfitojnë **shërbime të ndihmës juridike parësore n***<br><br>- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në **Tiranë** (n<br>- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në **Durrës** (<br>- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në **Fier** (në<br>- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në **Lezhë** (n<br>- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike në **Lushnje** (me buxh<br><br>Referuar planit të punës për gjashtëmujorin e dytë të vitit, është paras shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e **Pogradecit**[7] **dhe Gj**<br><br>Gjithashtu, me shkresën nr.5158/2 prot., datë 05.10.2020, nga Ministria Juridike Falas.<br><br>**Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihme**<br><br>Pranë ambjenteve të Ministrisë së Drejtësisë, me prezencën e Ministres Juridike Falas në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lezhë.<br><br>Në këtë takim ju kushtua një rëndësi e veçantë diskutimit mbi mënyrat qendren e re të inaguruar në qytetin e Lushnjes më datë 08.09.2020, si juridike falas, si një ndër prioritetet kryesore të Minitrisë së Drejtësisë.<br><br>Gjatë këtij takimi nga ana e zj. Ministre u theksua rëndësia e shërbimit me qëllim **ndarjen e vizionit të përbashkët** sipas rrethit ku ato opere grupeve që adresohen pranë këtyre zyrave. Një analizë e tillë do të shërb sipas nevojave të evidentuara më sipër.<br><br>Gjithashtu, në fokus të veçantë duhet të jetë puna e vetë qendrave për të juridike të garantuar nga shteti.<br><br>Në këtë kuadër, qendrat duhet të punojnë **për të forcuar bashkëpuni** ndihmës juridike; hartimit dhe publikimit të materialeve të vizibilitetit s këtyre zyrave duke krijuar qëndrueshmëri institucionale sa i përket ndih<br><br>Lidhur me shërbimin e ndihmës juridike parësore i ofruar përmes qendra |

[7] Është planifikuar zhvillimi i inagurimit të qendrës më datë 8 Tetor 2020.

[8] Është planifikuar zhvillimi i inagurimit të qendrës brenda muajit Tetor 2020.

[9] Kjo qendër ishte funksionale deri në korrik të vitit 2020 dhe në vijim për shkak të numrit shumë të ulët të rasteve nga ana e Soros si donator kryesor, u vendos mbyllja e kësaj qendre. DNJF, nga ana tjetër kërkoi miratim nga Ministri i Drejtësisë për të rihapur këtë qendër dhe për ta bërë pjesë të struktuave organizative të saj me qëllim shtrirjen dhe zgjerimin sa më shumë të shërbimeve të ndihmës juridike parësore përmes hapjes së qendrave në qarqe të ndryshme të vendit.

Qendra Tiranë ka trajtuar **422** raste; Qendra Durrës ka trajtuar **211** rast

<u>**Bashkëpunimi me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit t**</u>

DNJF është duke bashkëpunuar me ***6 klinikat ligjore*** me të cilat jan
përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikav

1. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;
2. Kolegji Universitar "Ëisdom";
3. Universiteti "Aleksandër Mojsiu" Durrës;
4. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;
5. Universiteti Europian i Tiranës.
6. Kolegji Universitar "Bedër".

Gjithashtu, në funksion të shtrirjes së këtij bashkëpunimi edhe me Unive
si dhe **Klinikën e Ligjit pranë Universitetit "Mesdhetar të Tiranës"**.

DNJF në kuadër të promovimit të këtij sistemi ka planifikuar zhvillin
organizohet brenda muajit Tetor 2020.

<u>**Autorizimi i Organizatave Jofitimrurëse për dhënien e ndihmës juri**</u>

**Një nga risitë thelbësore të ligjit nr. 111/2017**, "Për ndihmën juridike

***Për herë të parë parashikohet një procedurë tërësisht e re, procedurë***
këto organizata operojnë.

Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të gara
një procedure të detajuar e cila është e parashikuar **në dy akte nënligjor**

- <u>Vendimi nr. 55 datë 06.02.2019</u>, i Këshillit të Ministrave, "*I*
  *shteti*";
- <u>Vendimi nr. 110, datë 06.03.2019</u>, i Këshillit të Ministrave, "
  *garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i s*

**Organizatat jofitimpruëse** krahas Qendrave të shërbimit të ndihmës j
***shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në mënyrë profesion***

***Ka përfunduar i gjithë procesi i autorizimit të OJF-ve në bashkëpu***
autorizimeve nga ana e Ministrit të Drejtësisë të 12 organizatave jofitim

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | 1. Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara;<br>2. Shërbimi Ligjor Falas “TLAS”;<br>3. Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Qytetare dhe Fshata<br>4. Qendra “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”;<br>5. Shoqata “Shërbimet Shqiptare për Refugjatët dhe Migrantët”<br>6. Shoqata Intelektualët e Rinj Shpresë;<br>7. Qendra “A.L.T.R.I.”;<br>8. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare;<br>9. Qendra “Konsumatori Shqiptar”;<br>10. Shoqata “Forumi i Gruas Elbasan”;<br>11. Shoqata “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”<br>12. Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë”.<br><br>Jo vetëm do të përfitohet shërbim ligjor falas, **por do të garantohet gj** **kontrollit dhe mbikëqyrjes** nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në<br><br>Autorizimi i OJF-ve është **një procedurë e re**, **një mekanizëm i ri** që organizatave në këtë kuadër, **është një garanci e shtuar** për çdo qyteta **ndryshme** (Tiranë, Elbasan, Berat, Shkodër), duke bërë të mundur kësh<br><br>Nga momenti i autorizimit më datë 10 shtator 2020 dhe deri në fund të r<br><br>**Dhënia e ndihmës juridike ONLINE**<br><br>Në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e me qytetarin, kurrësesi ndihma juridike nuk mund të mos ofrohej dhe në<br><br>Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin përmes **platformës juristionline.al.** Përmes kësaj platforme çdo qyteta normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe me nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërk<br><br>Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të sa rezultativ.<br><br>Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksseshme pasi vihet re një numër i |

Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas
është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndë
cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me një
duke vijuar të analizojë me kujdes përgjigjet e avokatëve/juristëve të an
shprehemi në seksionin e monitorimit të ofrimit të cilësisë së shërbimit.

Ndihma juridike online nëpërmjet platformës juristionline.al është ofrua

**Vendosja në dispozicion e numrit të gjelbër (falas) 08001010**

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë ne
në të cilën do të kenë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndih
për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për
shërbime sa më pranë qytetarit. Si platforma ashtu edhe numri i gjelbër

**Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore:**

Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas
është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndë
cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me një

Referuar Ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga s
ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shër

Ofruesit e ndihmës juridike parësore janë:

- Qendrat e Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Pa
- Organizatat jofitimprurëse të autorizuara për ofrimin e
- Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (me të cilat DNJF ka lid

Duke qënë se ka përfunduar autorizimi i OJF-ve në për ofrimin e ndihm
nuk ka përfunduar ende procesi i lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpu
*bashkëpunimin me DNJF*), procedurat e mbikëqyrjes kanë vijuar duke u

- ***Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në***

Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me
rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punë
ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respekti
përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në M

- ***Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore ne***

Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me
rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respekti<br>përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në M<br><br>- ***Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore ne***<br><br>Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me<br>rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punë<br>ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respekti<br>përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në M<br><br>- ***Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore ne***<br><br>Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me<br>rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punë<br>ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respekti<br>përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në M<br><br>Me përfundimin e monitorimit të të gjitha qendrave funksionale të shër<br>qëllim, DNJF me shkresën nr. 341 prot., datë 20.08.2020, i është drejtua<br><br>**Mbikëqyrja e shërbimit të ndihmës juridike online.**<br><br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të vlerësimit të cilësisë të<br>në vijim. Është përfunduar tashmë raporti tre mujor për periudhën ko<br>mbikëqyrjen (dy specialistë të ngarkuar nga secila drejtori), si dhe me di<br><br>**Lidhur me fushatat e ndërgjegjësimit**, DNJF, bazuar në Ligjin nr 11<br>ligjor të publikut duke mos u ndalur vetëm tek sistemi i ndihmës juridik<br>aktivitete me karakter ndërgjegjësues, të cilat do të vijojnë përgjatë gjit<br>detajuar masash , dedikuar posaçërisht aktiviteteve dhe seminareve ndër<br><br>Për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të COVID-19, sh<br><br>***Aktivitet Ndërgjegjësues "Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt***<br><br>Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktivtiteti "Aksesi në drejtësi për të<br>zhvillua në 3 seksione ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën m<br>shërbimet ligjore falas.<br><br>Të miturve ju vendos në dispozicion një manual i thjeshtëzuar me 7 pye<br><br>✓ Çfarë është Ndihma Ligjore Falas?<br><br>✓ Kush përfiton nga ky shërbim?<br><br>✓ Çëlloj mbrojtjeje mund të gjej? |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | ✓ Kujt mund t'i drejtohem për të përfituar nga ky shërbim?<br>✓ Cila është procedura që duhet të ndjek?<br>✓ Si mund të na kontaktoni?<br><br>Të miturit gjatë takimit informues u shfaqën mjaft të interesuar për t'u lidheshin më së tepërmi me "detyrimin për ushqim" si dhe me kërkesat p<br><br>Me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave dhe përfitimin e shërbimit të gatshëm për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas në<br><br>***Tryezë e Përbashkët në kuadër të promovimit dhe nxitjes së sistemit*** Gjyqesor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Policisë Vendore dhe Paresore dhe fokusin për te rritur urat e bashkëpunimit nderinstituciona aktorët ndër institucionalë.<br><br>***Intervistave televizive me qëllim përcjelljen e njohurive mbi sistemin e*** Shqipëri" në Radio Televizionin Shqiptar gjatë të cilit është diskutuar m përfituese.<br><br>Gjatë këtij viti, sipas planit të punës së DNJF, janë parashikuara një sër clat janë më pak të informuara referuar të dhënave që disponohen ng parashikohet është dhe edukimi ligjor, në formë seminari / këshillimi ju<br><br>**Promovimi i sistemit të ndihmës juridike falas**<br><br>- **Publikimi i manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike fa**<br><br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe ed 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", ***ka vijuar me*** ndihmën juridike u është përcjellë disa institucioneve si Bashkia Tiranë,<br><br>- **Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytë**<br><br>DNJF në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti, ka zhvilluar një sër adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishi<br><br>Në këtë kuadër më datë 29.09.2020, Drejtoria e Ndihmës ka vijuar me |

[10] Ky manual përbëhet nga disa rubrika si vijon: Çfarë është Ndihma Ligjore Falas; Kush përfiton nga ky shërbim; Ç`lloj mbrojtjeje mund të gjej; Kujt mund t'i drejtohem për të përfituar nga ky shërbim; Cila është procedura që duhet të ndjek; Si mund të na kontaktoni. **Manualin e publikuar e gjeni në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.**

[11] Shkresa me nr. 334/1 prot., datë 18.08.2020; Shkresa me nr. 334 prot., datë 18.08.2020; Shkresa me nr. 334/2 prot., datë 18.08.2020, me lëndë: "Përcjellim për dijeni manualin "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas".

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | institucioneve.<br><br>- **Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare** **ndihmajuridik**<br><br>Që prej muajit Mars 2020[12] faqja është finalizuar dhe është vendosur n transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e<br><br>- **Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike fala**<br><br>Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur n punuar në mënyrë të vazhdueshme për promovimin e këtij sistemi për procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e këtij shërbimi si dhe janë n<br><br>**Forcimi i kapaciteteve / trajnime të kryera:**<br><br>**Trajnimi i punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridik** qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me traj *Falas bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për mir standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve n*<br><br>Sa më sipër, nga ana e ASPA-s**, me shkresën me nr. 7006/4 prot., d punonjësit me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të n**<br><br>***Sa më sipër, në kushtet kur buxheti i Drejtorisë së Ndihmës Juridike*** UNDP mbështetjen qoftë atë financiare (pagesa e trajnimeve të ASPA-s të detyrueshëm të punonjësve të qendrave përmes angazhimit të disa eks<br><br>**Më datë 24.09.2020**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridik<br><br>Në këtë trajnim, punonjësit e qendrave përfituan njohuri më të thelluar duke i kushtuar një rëndësi të veçantë kuadrit ligjor specifik për kateg trafikimit; të miturve në konflikt me ligjin; personave që përfitojnë nd zhvillohen në vijimësi, në kuadër të forcimit të kapaciteteve të mëtejshm |

12 Për sa i përket hapjes së faqes zyrtare Ëeb të DNJF, në kushtet kur institucioni ynë nuk ka në organikën e tij një specialist përgjegjës për çështjet e teknologjisë së informacionit, ka kërkuar mbështetjen e EURALIUS.

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. Sistemi i Ndihmës Juridike Dytësore ka funksionalitet të plotë. | DNJF;<br><br>Gjykatat;<br>DHKA;<br>SHM | 75% e nevojave janë përmbush ur, përfshi edhe grupet vulnerabël në të njëjtën masë; Janë zhvilluar fushata ndërgjegjë suese; | 135 000 | | | | Realizuar | **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas**<br><br>Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e m<br>11 ose 12 të ligjit nr.111/2017.<br><br>Për vitin 2020 janë lidhur kontrata me **73 avokatë** për ofrimin e ndihmë<br><br>DNJF në përmbushje të detyrave të saj funksionale të parashikuara në n<br>e tyre nëse kërkesat me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore janë<br>,datë 22.07.2020, me kërkues zj. Violeta Marku, pasi Gjykata ka keqint<br>mohuar kërkueses të drejtën kushtetuese për të përfituar avokat falas.<br><br>Gjithashtu, DNJF ka proceduar me kërkesa për ndreqje gabimesh të ve<br>poshtë:<br><br>- *Caktim nga ana e gjykatës të avokatit që do të përfaqësojë kërk*<br>*shteti" ia atribuon Dhomave Vendore të Avokatisë;*<br>- *Moszbatim parashikimesh të nenit 23 të ligjit Nr.111/2017, duke m*<br>- *Mosparashikim i të drejtës së ankimit ndaj vendimit gjyqsor dhe a*<br>- *Disponim mbi kërkesë për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet g*<br><br>Aktualisht janë kryer **14**[14] kërkesa për ndreqje gabimesh ndaj vendimev<br><br>Janë ekzekutuar detyrime kontraktuale të strukturës së mëparshme **KSH**<br><br>Gjithashtu janë kryer **7 pagesa të detyrimeve kontraktuale** me avokat<br><br>Për sa i përket detyrimeve të përcaktuara në nenin 31 të ligjit: Rastet e<br>shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rrethanat në një mënyrë të tillë<br>rastin e dhënies së informacioneve të rreme ose të pavërteta, DNJF për<br>rastet e përcaktuara në nenin 31 dhe 32 të ligjit.<br><br>***Totali i Vendimeve Gjyqësore për periudhën Janar – Shtator 2020 = 1***<br><br>***89- pranim kërkesash për ndihmë juridike dytësore***<br>***15 - rrëzime të kërkesës për ndihmë juridike dytësore***<br>***1 - vendim pushim çështjeje*** |

[13] Në vijim, DhASh.

[14] Janar-Shtator 2020

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | **Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dytësore**<br><br>Mbikëqyrja ka vijuar dhe për shërbimin e ndihmës juridike dytësore të<br>filluar procesi i mbikëqyrjes dhe kontrollit. Është ngritur grupi i punës d<br><br>Gjithashtu, **ka përfunduar faza e parë e monitorimit për të gjithë**<br>rezultuar nga monitorimet në terren. Për këtë qëllim, DNJF me shkresë<br>monitorimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.<br><br>Në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike<br>ndihmës juridike falas me eficiencë, cilësi dhe efektivitet.<br><br>**Trajnimi i avokatëve të ndihmës juridike dytësore:**<br><br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të bashkëpunimit ndërin<br>juridike të garantuar nga shteti", neni 9, gërma d) parashikon si detyrë të<br>*që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me D*<br><br>Ky parashikim ligjor gjen mbështetje dhe në ligjin nr. 55/2018 "Për Pr<br>*përfshihen në listën e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë për ofrimin e*<br>*sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti,*<br><br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur kontrata për ofrimin e shër<br>është propozuar që trajnimi vazhdues të zhvillohet për të 73 ofruesit e sh<br><br>Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndihmës Juridik<br>duke u përqëndruar kryesisht në ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridi<br>të lidhura specifikisht me kategoritë e veçanta përfituese/grupet vulneral<br><br>Jemi duke dakordësuar me DhASh për të zhvilluar trajnimin vazhdues o |
| | | | | | | | | **SHM**<br>Shkolla e Magjistraturës miraton në çdo muaj shtator të vitit, kalendarin e trajnimeve të një viti akademik. Tema e "Ndihmës Juridike të Garantuar nga Shteti" është përfshirë në kalendarin e trajnimeve për vitin akademik 2019-2020, në datën 20-21 nëntor 2019. Në këtë trajnim morën pjesë 12 gjyqtarë dhe 1 Avokat Shteti.<br><br>**DhASh** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Organizimi i një takimi të përbashkët ndërmjet DHASH dhe Drejtorit të sapoemëruar të DNJF me datë 30 qershor 2020 me qëllim përcaktimin dhe forcimin e bashkëpunimit lidhur me trajnimin e avokatëve të listës së ndihmës juridike dhe hartimin e një programi të vecantë trajnimi për këta të fundit.<br><br>Sqarim: Lidhur me raportimin e mëparshem sa i takon procesit të shortit dhe listimit të avokateve sipas këtij të fundit sqarojmë se ky proces është finalizuar brenda afatit ligjor me 1 shkurt. Është hedhur shorti në DHASH sipas procedures së përcaktuar në ligjin e ndihmës juridike nr.111/2017. Avokatët janë listuar sipas këtij shorti dhe nje kopje e listës së avokatëve sipas shortit i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë me 1 shkurt 2020. |
| ***Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave antikorrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale***<br>***Nën-objektivi 4/a: Përmirësimi i eficencës dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë penale sipas standardeve evropiane*** | | | | | | | | |
| **Masat / Aktivitetet e parashikuara** | **Institucioni Përgjegjës** | **Targeti / Milestones 2020** | **Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021** | | **Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)** | | **Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020** ***(E realizuar / në proces / e parealizuar)*** | **Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020** |
| | | | **PBA** | **Donatorë** | **PBA** | **Donatorë** | | |
| 1.Monitorimi i rasteve të paraburgimit për vepra të vogla si dhe të numrit të të miturve në paraburgim (nga proçesi i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarëve dhe procesi disiplinor). | KLGJ | Identifikimi vjetor i rasteve, analiza në nivel makro dhe nxjerrja e rekomandimeve për institucionet përkatëse. | 1800 | | | | Realizuar | **KLGJ**<br>Skema e re e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve është miratuar, (shih Nën-objektivi 1/c, pika 5).<br>Sistemi aktual i menaxhimit të çështjeve nuk e gjeneron një statistikë të tillë.<br>Në kuadër të përgatitjes së raportit vjetor, për vetë sensitivitetin e çështjes, nga gjykatat kërkohet raportimi për dënimet alternative për çështjet penale me të mitur dhe këto të dhëna janë pjesë e raportit vjetor të KLGJ-së për vitin 2019. |
| 2.Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme që synojnë: | PP | A) Rritja 2 % çështjeve dërguar në gjykatë për vepra me rrezikshm ëri të lartë shoqërore, krahasuar me vitin 2019<br><br>B) Rritja 10 % e kërkesave të prokurorit për masa alternative | 2 000 | | | | Realizuar | **Prokuroria e Përgjithshme**<br>Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe kuadrit ligjor për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe inicimin në Kuvendin e Shqiperise (Komisionin e Ligjeve) për miratim të një shtese në nenin 287 të K.Penal, në përqasje me nenin 9 (3) të Konventës së KiE-së "Për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe financimi i terrorizmit" e ratifikuar me ligjin nr.9646/2006, sipas rekomandimit për Shqipërinë nga Konferenca e |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a) Rritjen e eficiencës së hetimit;<br><br>b) Rritjen e aplikimit të masave të sigurimit të ndryshme nga masa me arrest në burg për veprat penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore (deri në 5 vjet burgim) | | sigurimi të ndryshme nga ajo me burg, krahasuar me 2017 baseline | | | | | | Palëve të kësaj Konvente të KiE-së me 22/23 Tetor 2019, ashtu dhe në kuadrin e përafrimit të këtij neni të K.Penal me Direktivën (BE) 1673/201 të Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 23 Tetor 2018 "Për luftën kundër pastrimit të parave sipas ligjit".<br><br>Udhëzim i Përgjithshëm nr.2, datë 10.03.2020 "Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19"<br>Udhëzim i Përgjithshëm nr.3, datë 19.03.2020 "Për disa masa proceduriale ne prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes COVID-19"<br>Udhëzim i Përgjithshëm nr.4, datë 24.03.2020 "Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19"<br>Udhëzim i Përgjithshëm nr.5, datë 08.05.2020 "Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19"<br><br>Gjatë periudhës raportuese është nënshkruar:<br>-Memorandumi i Bashkepunimit mes Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (perfshi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave) dhe Ministrit të Brendshëm (përfshi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara) "Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF dhe planit të veprimit ICRG/FATF"<br><br>Gjatë periudhës raportuese janë miratuar:<br>-Udhëzimi i Përgjithshëm nr.7, datë 13.05.2020 "Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | ekspertizës";<br>-Udhëzimi i Përgjithshëm nr.8, datë 19.05.2020 "Për shpenzimet proceduriale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm";<br>-Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020 "Për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e aseteve/pasurive produkt i veprimtarise kriminale" për krijimin e seksioneve të posaçme në prokurori dhe në strukturat hetimore të shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit dhe agjensit ligjzbatuese të tjera dhe rritjen/forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në procedurat standarde në veprimtarinë hetimore, polici/agjenci të tjera ligjzbatuese – prokurori;<br>- Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 11, datë 20.07.2020 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm";<br>Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 "Mbi rregullimin e marrëdhenieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm ". |
| 3. Garantimi i kushteve të punës sipas standardeve bashkëkohore nëpërmjet:<br><br>a) Shtimi i stafit mbështetës në funksion të prokurorit;<br><br>b) Investime në infrastukturë; Ndërtime të reja; Rikonstruksion;<br><br>c) Trajnimi vazhdues i oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit të nëpunësve civilë. | PP, KLP, PP | Ulje e ngarkesës mesatare për prokuror me 10 %krahasuar me ngarkesën e vitit 2018<br><br>Trajnim vazhdues profesiona l | 205 900;<br><br>për n/masën e ndarë:<br><br>a)192 000;<br>c) 13 900 | 99 385; për n/masën b) e ndarë;<br><br>b) 2 085: 97 300 | KLP<br>11 000 (në mijë lekë)<br>PP<br>66,144 | | Në proces | **PP**<br>a. Janë rekrutuar gjatë periudhës raportuese:<br>- 1 Drejtor me status civil<br>- 3 përgjegjës sektori<br>- 4 specialistë<br><br>b) Masa (b) perfshin rikonstruksione ne shumen 69.862 mije leke. Konkretisht, për vitin 2020 janë planifikuar ( buxheti i rishikuar) fonde në total për rikonstruksione 69,862 mijë lekë, nga të cilat shuma 65,744 është planifikuar për rikonstruksion të dy ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e PP dhe Prokuroria e shkallës së Parë Kurbin e cila është duke zhvilluar punimet. Ndërsa shuma prej 4.118 mijë lekë (buxhet i rishikuar) është planifikuar për 10 prokurori dhe përfshin: blerje kangjella e dyer të blinduara në kuadër të ruajtjes së dokumentave. Fondi është |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | realizuar në 5 prokurori Elbasan, Fier, Kukes, Mat, Pogradec ndërkohë që prokurorite Korçë, Lezhë, Sarandë, Tropojë janë në proces. Pë prokurorinë e Apelit Korçë fondi nuk mund të përdoret dhe është rialokuar në muajin Tetor.<br><br>c) Kanë kryer trajnimin detyrues 2 nëpunës civil të cilët kanë qenë në periudhe prove.<br>Për shkak të situatës së pandemisë, nuk janë kryer trajnime për nëpunësit civil.<br><br>Lidhur me trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore, Komisioni i Policisë Gjyqësore dhe Shkolla e Magjistraturës po përgatisin programin e trajnimit fillestar për Oficerë të Policisë Gjyqësore. Ndërkohë për periudhën janar – shtator kanë marrë pjesë në trajnime të organizuar nga SHM, 81 Oficerë të Policisë Gjyqësore.<br><br>**KLP**<br>Për periudhën e raportimit, është parashikuar blerja e sistemeve audio, video dhe përkthim simultan.<br>Nuk ka përfunduar ende procedura e prokurimit. |
| 4. Rritja e eficencës së përgjimeve në procesin penal, nëpërmjet:<br><br>a) Realizimi i procesit te decentralizmit të përgjimit të komunikimeve elektronike pranë prokurorive;<br><br>b)Zgjerimi i kapaciteteve për përgjimin aktiv. | PP | Pergjimet realizohet në secilën prokurori | | 231 130 | | | Në Proces | **PP**<br>**a**) Në lidhje me decentralizimin, Sektori i Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme vazhdon bashkëpunimin me Projektin Pameca 5 për gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme.<br>Gjatë periudhës raportuese kemi vijuar bashkëpunimin me projektin Pameca lidhur me gjetjen e zgjidhjeve teknike për realizimin e kësaj mase.<br>Jemi në proces vlerësimi të tyre.<br><br>b) Për përgjimin aktiv Sektori Pergjimeve në datë 10.04.2020 ka kryer nje trajnim (ëebinar) mbi:<br>- Social Media Intelligence and OSINT;<br>- Medical Emergency detection system; |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Pjesmarrës: 3 Oficerë të Policisë Gjyësore<br>Pa kosto për PP.<br><br>Nuk ka zhvillime për periudhën raportuese. |
| ***Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar procedurat dhe lehtësirat moderne të sistemeve elektronike për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar***<br>***Nën-objektivi 5/a: Përmirësimi i gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe përmirësime të tjera në infrastrukturë*** | | | | | | | | |
| **Masat / Aktivitetet e parashikuara** | **Institucioni Përgjegjës** | **Targeti / Milestones 2020** | **Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021** | | **Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)** | | **Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020** ***(E realizuar / në proces / e parealizuar)*** | **Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020** |
| | | | **PBA** | **Donatorë** | **PBA** | **Donatorë** | | |
| 1.Krijimi i një platforme të unifikuar IT për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit. (përfshirë platforma për menaxhimin e çështjeve) **<u>(Në funksion dhe të objektivit 1a)</u>** | KLGJ | Projektimi , prokurimi i sistemi të ri të menaxhim it të çështjeve në gjykata (ICMIS të ri). | | 469 350 | | | Në Proces | **KLGJ**<br>Këshilli ka ndërmarrë masat e nevojshme për të mundësuar transferimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve dhe kontratat përkatëse nga MD. Ky sistem është marrë në administrim nga KLGJ në muajin shtator të vitit 2019.<br><br>Gjithashtu, është bashkëpunuar me MD duke dhënë opinion lidhur me projekt-vendimin për ngritjen e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit. Aktualisht, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë, nuk është ngritur ende dhe kjo për rrjedhojë ka penguar përmbushjen e masave lidhur me zhvillimin e një programi pilot për gjykatat.<br><br>Në zbatim të Urdhërit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 232, datë 4.11.2019 "Për ngritjen e Grupit të Punës, për kryerjen e një studimi, në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve në gjykata", u realizua studimi dhe Këshillit ju paraqit një raport analitik, duke renditur problematikat e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata, sipas kategorive të prioriteve, për t'u mbajtur parasysh për përmirësimin e sistemit. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | KLGJ është duke kryer një studim për zhvillimin e projektit në lidhje me sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve. Është parashikuar nevoja për resurse financiare, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë (Misioni EURALIUS V) por kostoja përfundimtare do të përllogaritet në përfundim të miratimit të projektit dhe opsioneve të përzgjedhura.<br><br>Sistemi i ri pritet të jetë një sistem i unifikuar me mundësinë e bashkëveprimit me sistemet aktuale në përdorim nga institucionet e tjera (Prokuroria, QKB, etj.), në përputhje me praktikat dhe me standarded me të mira ndërkombëtare. |
| 2. Krijimi i qendrës së centralizuar të mbështetjes së funksionimit të TIK (ITOSC) që do të qeverisë sistemet TIK të gjykatave, KLGJ, KLP, ILD. | MD, KM, Qendra TIK | QENDRA ESHTE NE FUNKSIONIM TE PLOTE. | | 70 803 | | | Në proces | **MD**<br>Në lidhje me realizimin e kësaj mase, nga ana Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit është hartuar projektvendimi “Për krijimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”. Aktualisht projektvendimi i është nënshtruar procesit të konsultimit të brendshëm (ministritë e linjës dhe organe të administratës publike), janë mbajtur disa takime me përfaqësues të Euralius dhe Justice for All, me synimin e dakordësimit të një drafti.<br>Aktualisht, drafti është në fazë ripunimi në kuadër të komenteve dhe më pas do të vijojë bashkërendimi për mendimet e ardhura.<br>**KM, Qendra TIK**<br>AKSHI nuk është i përfshirë aktualisht në këtë projekt dhe për rrjedhojë nuk ka informacion sa i takon krijimit të ITOSC. |
| 3.Blerje dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektronike për gjykatat | KLGJ, Gjykatat | <u>96%</u> | 175 000 | | | | Realizuar | **KLGJ**<br>Blerja dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektronike është realizuar nga të gjitha gjykatat sipas parashikimeve buxhetore.<br>Gjithashtu KLGJ ka realizuar procedurat e prokurimit për 3 procese:<br>– "Abonim programi financiar në Cloud” për 38 gjykata<br>– “Mirëmbajtje e sistemit audio RDA nëpër |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | sallat e gjyqit në Gjykata" për 38 gjykata<br>– "Mirëmbajtje e sistemit ICMIS dhe ARKIT" për 38 gjykata. |
| 4. Pajisja e organeve të reja të drejtësisë me infrastrukturën elektronike të nevojshme (KLGJ/ILD/KLP)<br><br>4.1. Pajisja e organeve të reja të drejtësisë me infrastrukturën elektronike të nevojshme (SPAK/ GJKKKO) | KLGJ, KLP, ILD<br><br>SPAK/ GJKKKO | Sistemi i brendshëm (softi) i menaxhim it të brendshëm në funksion ( i veçantë për çdo institucion ) Vendosja/i nstalimi I pajisjeve IT dhe vënia në funksion e tyre Sistemi i brendshëm (softi) i menaxhim it të brendshëm i zhvilluar ( I VECANTE PER CDO INSTITUCION) | | 110 308,<br><br>KLGJ<br>43 515,<br><br>KLP<br>44 640<br><br>ILD<br>22 153<br><br>234 675;<br><br>SPAK 227 970;<br><br>GJKKKO<br>6 705 | 7 415 (në mijë lekë)<br><br>4 382 (në mijë lekë) | | Në Proces | **KLGJ**<br>KLGJ ka siguruar pjesën kryesore të infrastrukturës elektronike të nevojshme. Procesi po vijon edhe në varësi të transferimit të institucionit në godinën e Polit të Drejtësisë.<br>Duke marrë shkas nga vijimi i situatës së fatkeqësisë natyrore në vend, e krijuar nga Pandemia COVID-19, ky proces mund të shtyhet në kohë, për shkak të kufizimeve buxhetore me të cilat përballet edhe sistemi gjyqësor.<br>GJPKKKO u ngritën si gjykata me vendimin e KLGJ nr. 286 datë 18.12.2019. Nevojat për pajisje elektronike dhe plotësimi i tyre po shqyrtohen dhe po realizohen gjatë vitit 2020.<br><br>**KLP**<br>Ndihmë/ Dhuratë nga Ambasada Amerikane (OPDAT) në pajisje elektronike (Sipas letër marrëveshjes më Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës , më 31.12.2019).<br><br>Ndihmë/ Dhuratë nga Ambasada Amerikane (OPDAT) në pajisje elektronike (Sipas letër marrëveshjes më Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës , më 10.06.2020).<br><br>**ILD**<br>Lidhur me këtë aktivitet të parashikuar, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë nuk është ndërmarrë ende veprim mbi pajisjen e institucionit me infrastrukturën elektronike të nevojshme, kjo për shkak të mungesës së mjediseve te nevojshme për zyra.<br><br>**GJPKKO**<br>Buxheti faktik i realizuar per blerje pajisje elektronike per GJKKKO eshte: Plan 1,150,000. Fakt 896,400 me te cilat jane blere 3 (tre) kompjutera sallash gjyqi tip ëorkstation, 2 (dy) videokonferenca portabile, 1 (nje) skaner. Me fondet e lira te krijuara nga procesi i prokurimit jane ne proces prokurimi 1 (nje) pajisje fonie (mikrofon). |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | **GJPAKKO**<br>Ne Gjykaten e Posaçme te Apelit per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka fonde investimi nga donatoret ,por kemi fonde vetem nga Buxheti i Shtetit te cilat kapin vleren 1 710 mije leke dhe perbehen nga fondi prej 400 mije leke pajisje elektronike, si dhe 1.060 mije pajisje zyre dhe sigurie dhe 250 mije leke per riparim deme termeti dhe lyerje .<br>Arsyeja e mbetjes se parealizuar eshte situata e paparashikuar e krijuar nga nga gjendja e Covid 19. |
| 5.Investim sipas standardeve bashkëkohore në godinat e gjykatave<br><br>5.1 Përmirësimi i infrastrukturës së godinave të gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë e Durrës, (rikonstruksion dhe ndërtimi i godinave të reja). | KLGJ, Gjykatat | <u>58%</u> | 352 000 | | | | Në Proces | **KLGJ**<br>Realizimi i investimeve infrastrukturore në gjykata varet nga rezultati i hartës së re gjyqësore me qëllim për të rritur eficiencën e shpenzimeve buxhetore.<br><br>Pandemia COVID-19 detyroi shtyrjen në kohë të të gjitha investimeve infrastrukturore për periudhën e karantinës.<br><br>Në vijim, realizimi i investimeve do të shqyrtohet rast pas rasti, për shkak të kufizimeve buxhetore me të cilat përballet edhe sistemi gjyqësor. |
| 6. Përmirësimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve në prokurori, duke reflektuar në të edhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe trajnimi i stafit | PP | Sistemi përdoret 100 % nga përdoruesi t dhe siguron besueshmë ri të dhënash | | 40 230 | | | E Parelizuar | Kompania implementuese ka komunikuar që po punon në këtë drejtim por ende nuk ka zhvillime konkrete. |
| 7. Krijimi i kanaleve të sigurta të komunikimit për shkëmbimin e informacionit në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar | PP, MD | Sistemi eshte funskional | | 9 730 | | | Në proces | **PP**<br>Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë aktualisht janë duke punuar për ndërlidhjen e dy programeve kompjuterike ekzistuese (IMPRO dhe M-File), në mënyrë që të gjenerohen të dhëna përputhshme dhe të ndiqet vijueshmëria e praktikave në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar. Ministria e Drejtësisë me shkresen nr 2465/1 Prot, datë 04.05.2020, i ka kërkuar A.K.SH.I-t ndryshimin e arkitekturës së sistemit M-File për të bërë të mundur shkëmbimin e të dhënave me Sistemin IMPRO të Prokurorisë së Përgjitshme. Ndërkohë, përfaqësues të dy Institucioneve (ndërmjet Sekretarëve të Përgjithshëm, punonjësve të |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Drejtorive të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, përfshirë edhe Specialistët IT dhe përfaqësues të AKSHI-t) kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm për të bërë të mundur ndërlidhjen e sistemeve. Ministria e Drejtësisë, pas administrimit të përgjigjes nga AKSHI do nisë diskutimet për termat e referencës dhe nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi për shkëmbimin e të dhënave. Aktualisht nga ana ana e Prokurorisë së Përgjithshme është përgatitur dokumentacioni i duhur për aplikimin pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, lidhur me regjistrimin e Sistemit IMPRO si databazë shtetërore. Një nga kërkesat për regjistrimin e këtij sistemi si databazë shtetërore është që ai nuk duhet të përmbajë/administrojë/përpunojë të dhëna të klasifikuara “Sekret Shtetëror”. Sistemi IMPRO në Prokurorinë e Përgjithshme administrohet nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe të dhënat që përmbahen aty kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, të dhëna këto që shkëmbehen ndërmjet disa institucioneve, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit/ZQK Interpol Tirana, autoriteteve gjyqësore vendase, etj. Problematika e krijuar lidhur me faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dërgon të klasifikuara “Sekret shtetëror” akte të tilla si, njoftimet për arrestimet e subjekteve të shpallur në kërkim ndërkombëtar (për shtetas të huaj dhe shtetas shqiptarë), me qëllim ekstradimin nga dhe për jashtë shtetit, njoftimet për shpalljet në kërkim ndërkombëtar të shtetasve shqiptarë nga autoritetet e huaja gjyqësore, kërkesat për verifikimet e statusit aktual të subjektit, etj. Nga ana jonë i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të bëjë rivlerësimin e klasifikimit për aktet në këtë fushë. Vetëm pas këtij rivlerësimi, Prokuroria e Përgjithshme do të mund të regjistronte pranë AKSHI-t sistemin IMPRO si databazë shtetërore, duke bërë të mundur në vijim ndërlidhjen mes këtij sistemi me Sistemin M-File të Ministrisë së Drejtësisë, në përmbushje të rekomandimeve të MONEYVAL. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | **MD**<br>Eshte ne process permiresimi i sistemit për të garantuar aksesin me Prokurorinë e Përgjithshme me qëllim shkëmbimin e ndërsjelltë të informaciont dhe gjenerimin e statisitikave koherente, sic është rekomanduar në IO.2 MONEYVAL. Janë përcjellje pranë AKSHI-t termat e referencës (Terms of Reference) të hartuara në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme. AKSH-i ka filluar proceduren e prokurrimit |
| 8. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme IT në DNJF | MD | Infrastrukrura e IT-së mbulohet nga një kontratë mirëmbajtjeje | | 140 000 | | | E parealizuar | Nuk ka zhvillime. |
| 9. Përgatitja e një sistemi të integruar për publikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në Fletore Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, për publikimin e legjislacionit të përditesuar, të kodeve dhe të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave. | QBZ , AKSHI | Integrimi i ICMIS me publikimet elektronik e dhe plotësimi/ përditësim i i sistemit | 69 840 | | | | E Parealizuar | **QBZ**<br>Aktualisht, deri në momentin e këtij raportimi sistemi i QBZ "Arkiva Elektronike" nuk ndërvepron me sisteme të tjera, as me sistemin ICMIS .<br>Qendra e Botimeve Zyrtare është ftuar në takime vetëm për ndërveprim me sistemin e-akte.<br><br>**KSHI**<br><br>Nuk ka një kërkesë zyrtare nga intitucionet e përfshira që përdorin këto sisteme drejtuar AKSHI-t në mënyrë që të zhvillohen takime me qëllim incimin e këtij procesi për bashkëveprimin e dy sistemeve QBZ/ICMIS, ku ky i fundit është në pronësi të KLGJ, në kuadër të Ligjit Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", neni 277, pika 5.<br><br>**MD**<br>Në vijim të realizimit të kësaj mase, nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, është hartuar vendimi "Për miratimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | e brendshëm të Arkivit Elektronik të Akteve”, miratuar me vendimin nr. 855, datë 24.12.2019., botuar në Fletoren Zyrtare nr. 182, datë 30.12.2019. |
| 10. Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore dhe institucionale të Arkivës Gjyqësore (ASHSGJ-së). | ASHSGJ | Mobilimi me rafte arkivore I arkivës së sistemit gjyqëso për pjesën tjetër | 51 000 | | 9820 (mijë lekë) | | Në Proces | Proçedura e rikonstruksionit të godinës u anullua në vitin 2019 dhe kjo masë është rishikuar dhe rivendosur përsëri në vitin 2020. Godina është në fazë rindërtimi (32.8 % e realizuar). Për sa i përket mobilimit me rafte metalike, është në proçes të vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë. |
| 11. Krijimi dhe funksionimi i sistemit elektronik të arkivës gjyqësore. | ASHSGJ | Funksioni mi i sistemit elektronik (hedhja e të dhënave) | 28 800 | | | | E Parealizuar | Për këtë projekt, ASHSGJ raporton se KLSH ka rekomanduar revokimin e kontratës e kontratës. Për shqyrtimin e rekomandimit të KLSH është ngritur grupi i punës me qëllim analizimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet palëve. Për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 grupi nuk është mbledhur për shqyrtimin e rekomandimeve të KLSH.<br>**MD**<br>Në vijim të realizimit të kësaj mase, nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, është hartuar vendimi “ Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”, i cili është miratuar me vendimin nr. 888, datë 31.12.2019, botuar në Fleoren Zyrtare nr. 184, datë 31.12.2019. |

| *Objektivi 6: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit*<br>*Nën-objektivi 6/a: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit* | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masat / Aktivitetet e parashikuara** | **Institucioni Përgjegjës** | **Targeti / Milestones 2020** | **Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021** | | **Buxheti i shpenzuar për vitin 2020 (faktik)** | | **Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2020 *(E realizuar / në proces / e parealizuar)*** | **Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-shtator 2020** |
| | | | **PBA** | **Donatorë** | **PBA** | **Donatorë** | | |
| 1. Përfshirja e të burgosurve në aktivitete punësimi dhe rritja e numrit të aktiviteteve riintegruese:<br><br>1.1 Përfshirja e të burgosurve në aktivitete punësimi.<br><br>1.2 Ofrimi i kurseve të formimit profesional në aftësitë bazë dhe ato teknike.<br><br>1.3 Ofrimi i programeve të tjera edukative, sportive, sociale dhe kulturore. | DPB | Shtimi i numrit dhe llojit të kurseve profesiona le për shtetasit e burgosur.<br><br>Rritja e përfshirjes së shtetasve që frekuentoj në procesin e formimit profession al në masën me 15%.<br><br>Rritja e pjesëmarrj es së shtetasve të privuar nga liria në këto aktivitete në masën 20%. | | 2 000 | | | Realizuar | **Drejtoria e përgjithshme e burgjeve**<br>Rehabilitimi dhe ri-integrimi i të burgosurve konsiderohet si thelbi i misionit të sistemit të burgjeve. Në funksion të këtij qëllimi janë ndërmarrë masa të vazhdueshme për të bërë të mundur zbatimin e një regjimi kuptimplotë aktivitetesh për këtë kategori.<br><br>1.1 Një ndër komponentët bazë të punës ri-integruese që kryhet me personat me liri të kufizuar është aktivizimi i tyre në aktivitete punësimi. Në zbatim të dispozitave ligjore punësimi i të burgosurve konsiderohet si mjet rehabilitues dhe jo ndëshkues. Të burgosurit aktivizohen në aktivitete punësimi sipas mundësive që ofrojnë institucionet, kryesisht si mirëmbajtës, ndihmës kuzhinier, kopshtar, ndihmës në bibliotekë, etj. Është në zbatim një manual për stafet e edukimit për punën rehabilituese me personat me liri të kufizuar. Ndër të tjera, adreson çështjen e punësimit të burgosurve si një ndër komponentët bazë të punës ri-integruese dhe rehabilituese. Janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione lokale si Bashkia e Tiranës për të rritur mundësitë e ri-integrimit të personave me liri të kufizuar pas lirimit. Për periudhën janar-shtator 2020 janë punësuar mesatarisht në sistemin e burgjeve 542 të burgosur prej të cilëve 110 të paraburgosur.<br><br>1.2 Nisur nga situata e jashtëzakonshme e COVID 19 dhe si rezultat i masave të marra për parandalimin dhe përhapjen e tij në institucionet e burgimit prej muajit mars e në vijim janë pezulluar të gjitha aktivitetet në grup të burgosurve, në të cilat përfshihen kurset profesionale dhe programe të tjera edukative. Të dhënat për këto dy tregues raportohen për muajin janar-shkurt 2020. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi kanë bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional për zhvillimin e procesit të formimit profesional në IEVP. Në zbatim të kësaj marrëveshje, procesi i formimit profesional është zhvilluar mbështetur në kërkesat e të burgosurve, hapësirat fizike dhe bazën materiale që disponojnë institucionet, si dhe llojet e kurseve profesionale që ofrohen nga DRFP. Për periudhën janar-shkurt 2020, kurset profesionale janë ofruar në 9 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 287 të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), pikturë, pirografi, elektricist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, rrobaqepësi, punë me dru dhe saldaturë.<br><br>1.3 Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën aktivitete të tjera edukuese në të gjithë sistemin e burgjeve gjatë janar-shkurt 2020 është 2756. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 192 tema sociale në muaj dhe 37 recensione librash. Gjithashtu, janë zhvilluar 365 aktivitete ri-integruese. Është në zbatim një dokument politikash për trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve sipas nevojave të tyre, si dhe programe edukuese për të burgosurit në prag lirimi. Qëllimi i këtyre programeve është ri-integrimi i suksesshëm në shoqëri i të burgosurve dhe parandalimi i sjelljeve recidiviste. Këto kurse janë ndjekur nga 22 të burgosur.<br>**MD**<br>Miratimi i ligjit nr. 81/2020 “**Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”,** në funksion të aktiviteteve të përcaktuara për këtë nënobjektiv, ka si qëllim veç të tjerash edhe garantimin e rehabilitimit social dhe riintegrimit në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike të të paraburgosurve dhe të dënuarve madhorë dhe të mitur, duke iu garantuar këtyre të fundit format e motivimit nxitës në përputhje me parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit, ndihmën sociale, edukative, arsimore, psikologjike dhe fizike në përputhje me nevojat individuale dhe në përputhje me grup-moshën, |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | gjininë dhe personalitetin e tij.<br>Ligj ka parashikuar, planin individual për trajtimin e çdo të dënuari, të cilit i ofrohet asistenca nga ekipe multidisiplinare për të inkurajuar rikthimin dhe riintegrimin në shoqëri, ku ndër të tjera është parashikuar edhe punësimi.<br>Ligji garanton se puna e kryer nga i burgosuri shpërblehet dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni. Punësimi i të burgosurit ka si qëllim të garantojë fitimin, ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive për punë dhe njohurive profesionale, për riintegrimin në shoqëri pas përfundimit të kryerjes së dënimit.<br>Po kështu, ligji 81/2020, përmes neneve 43 dhe 44, parashikon për garantimin e të drejtës për punësim dhe zgjedhjen e punës që do të kryejë, brenda ose jashtë institucionit. Natyra e punës që kryhet nga i dënuari duhet të jetë në përputhje me gjendjen shëndetësore, njohuritë dhe aftësitë për punë, formimin profesional, karakteristikat e veçanta të personalitetit, si dhe me perspektivën e riintegrimit të tij në shoqëri. Ligji parashikon se i burgosuri punësohet nga administrata e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose nga persona juridikë privatë brenda ose jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve. Megjthatë,ndalohet punësimi jashtë institucionit i të burgosurit, që është vendosur në institucionet e sigurisë së lartë. Kontrata e punësimit e lidhur me një të burgosur nuk duhet të tregojë se ai ose ajo është duke kryer dënimin. Po kështu është vendosur edhe detyrimi për personelin e institucionit, që të nxisë dhe të krijojnë kushte për vetëpunësimin e të dënuarve.Ligji ndalon shprehimisht punën e detyruar ose punësimin si formë e dënimit disiplinor. |
| 2. Ulja e mbipopullimit në IEVP-të në përputhje me standardet evropiane. | DPB | Reduktim i mbipopulli mit në masën 2% | 373 000 | | | | Realizuar | Çështja e mbipopullimit në nivel të përgjithshëm në sistemin e burgjeve është një problematikë e zgjidhur. Kapacitet totale të sistemit të burgjeve janë 6106 vende dhe gjatë janar-shtator 2020 janë trajtuar |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | mesatarisht 4985 persona, prej të cilëve 282 shtetas me masë mjekësore mjekim i detyruar. Niveli i popullimit në fund të muajit shtator 2020 ka qenë mesatarisht -18% (-1121). Pra, sistemi i burgjeve në nivel të përgjithshëm ka qenë në kushtet e nënpopullimit.<br><br>Krahasuar me vitin 2019, niveli i popullimit të burgjeve është ulur me 6% (pra, nga -12% në -18%). Ulja e popullimit në burgje ka ardhur si rezultat i zbatimit të Ligjit Nr.5/2020 "Për Dhënie Amnistie", për të cilat janë marrë masat e duhura dhe të nevojshme për efektivitetin e aplikimit të tij në mënyrë sa më rigoroze, në të gjitha IEVP-të. Lidhur me amnistinë e vitit 2020, vlerësojmë se është ngjarja më e veçantë për kategori tejet delikate të shoqërisë tonë, pra për të dënuarit që vuajnë dënimin me burgim në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Shqipëri. Rëndësia e saj nuk qëndron vetëm për faktin se prej disa viteve me rradhë nuk ka pasur amnisti, qysh prej janarit të vitit 2017, por konsiston në lirimin e një pjese tejet të madhe të dënuarish 160 të tillë, prej të cilëve 21 gra dhe 1 i mitur.<br><br>Lirimi i të amnistuarve u krye sipas planifikimit në orën 16.00 datë 3.3.2020 nga IEVP përkatëse. Dhënia e amnistisë u bë me qëllimin që të mund të sjellë një zhvillim pozitiv në raport me këta shtetas/e që lanë qelitë, për tu bashkuar me familjet e tyre, si dhe të shërbejë si një shembull konkret reflektimi për ta dhe me ndikim të drejtëpërdrejtë në risocializimin në shoqëri. |
| 3. Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të të ndaluarve/ të burgosurve me probleme të shëndetit mendor. | DPB | | 62 629 | | | | Në proces | Në fund të muajit dhjetor 2019 një plan tranzitor masash është hartuar nga MSH dhe MD në kuadër të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të personave me masë mjekësore mjekim i detyruar. Zbatimi i planit u planifikua që të përmbushet gjatë 2020.<br><br>Në projektet prioritare të investimeve të sistemit të burgjeve përfshihet përfundimi i investimit për adaptimin e godinave 4 dhe 5 në IEVP Lezhë në ambiente spitalore për të trajtuar personat me masë mjekësore "mjekim i detyruar". Për vitin 2020 nuk fonde të mjaftueshme për të përmbyllur të gjithë |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | investimin. Janë parashikuar fonde në projekt-buxhetin e vitit 2021 për përfundimin e gjithë investimit.<br><br>Kërkesa për rritjen e pagave të mjekëve është përfshirë në kërkesat buxhetore të DPB-së për vitin 2020-2022, duke marrë në konsideratë komunikimet zyrtare me MF dhe MD.<br><br>**MD**<br>Garantimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor, është përcaktuar shprehimisht në nenin 5 të ligjit nr. 81/2020, si një e drejtë themelore. Më tej ligji në nenin 20 ka bërë një ndarje të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Ndërsa për personat me probleme të shëndetit mendor është përcaktuar se personat për të cilat gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme administrohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor, për sa i takon ofrimit të<br>Shërbimeve, pranë institucionet e kujdesit shëndetësor. Masat e sigurisë për ruajtjen e këtyre institucioneve ofrohen nga Ministria e Drejtësisë.<br>Në nenin 42 të ligjit nr. 81/2020, është përcaktuar edhe Shërbimet e kujdesit shëndetësor për kategori të veçanta se trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor sigurohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor. I burgosuri që gjendet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që ka çrregullime të shëndetit mendor gëzon të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë strukturave shëndetësore të specializuara për trajtimin e sëmundjeve të shëndetit mendor ose në qendrën spitalore të burgjeve, sipas rastit. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
